



June 25, 2018
*Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë
(CAO)*

RAPORT I HETIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

Investimi i IFC në enso Shqipëri (Project #30979)

Ankesa 01

Hetimi i CAO rreth Performancës Mjedisore dhe Sociale të IFC në Lidhje me Investimin e saj në enso Shqipëri (Projekti i Hidrocentralit në Lengaricë)

Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC)
dhe Agjencinë për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA), Anëtare të Grupit të Bankës
Botërore

Rreth CAO

Misioni i CAO është të shërbejë si një mekanizëm ankimor i pavarur, i drejtë, i besuar, dhe efektiv dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë mjedisore dhe sociale të IFC dhe MIGA.

CAO (Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë) është një post i pavarur që i raporton drejtpërdrejt Presidentit të Grupit të Bankës Botërore. CAO shqyrton ankesat nga komunitetet e prekura nga projektet e zhvillimit të ndërmarra nga të dy krahët e sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA).

Funksioni i përputhshmërisë në CAO mbikëqyr hetimet e performancës mjedisore dhe sociale të IFC/MIGA, veçanërisht në lidhje me projekte të ndjeshme, për të siguruar përputhshmërinë me politikat, standardet, udhëzimet, procedurat dhe kushtet e përfshirjes së IFC/MIGA, me synimin për të përmirësuar performancën mjedisore dhe sociale të IFC/MIGA.

Për më shumë informacion në lidhje me CAO, ju lutemi vizitoni www.cao-ombudsman.org<http://www.cao-ombudsman.org/>

Përmbajtja

Rreth CAO	2
Shkurtime	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
Përshkrim i Përgjithshëm i Procesit të Përputhshmërisë të CAO	7
1. Historiku	8
1.1. Investimi.....	8
1.1.1 <i>Investimi i IFC në enso Shqipëri</i>	8
1.1.2 <i>Projekti i Hidrocentralit të Lengaricës</i>	8
1.2. Ankesa dhe Vlerësimi i CAO	9
1.3. Objekti dhe Metodologjia e Hetimit.....	11
1.3.1 <i>Objekti i Hetimit të Përputhshmërisë</i>	11
1.3.2 <i>Metodologjia</i>	11
1.3.3 <i>Politika e Zbatueshme dhe Standardet e Performancës të IFC</i>	12
1.4. Përshkrim i Përgjithshëm i Shqyrtimit dhe Mbikëqyrjes së Investimit nga IFC.....	13
1.4.1 <i>Shqyrtimi Mjedisor dhe Social Para-Investimor i IFC</i>	13
1.4.2 <i>Angazhimi dhe Plani i Veprimit M&S</i>	13
1.4.3 <i>Mbikëqyrja e Projektit</i>	14
2. Analiza dhe Gjetjet	14
2.1. Llojet e rrezikuara dhe habitatet natyrore/kritike;	14
2.1.1 <i>Kërkesat e IFC</i>	15
2.1.2 <i>Diskutime dhe Gjetje</i>	17
2.2. Ndikimi mbi Jetesën e bazuar në Turizëm	22
2.2.1 <i>Kërkesat e IFC</i>	22
2.2.2 <i>Diskutime dhe Gjetje</i>	22
2.3. Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës	24
2.3.1 <i>Kërkesat e IFC</i>	24
2.3.2 <i>Diskutime dhe Gjetje</i>	25
2.4. Publikimi i informacionit, këshillimi dhe angazhimi i palëve të interesuara	28
2.4.1 <i>Kërkesat e IFC</i>	28
2.4.2 <i>Diskutime dhe Gjetje</i>	29

3. Përfundime dhe Vërejtje	31
Shtojca 1: Përmbledhje e Gjetjeve të Hetimit të CAO	33
Shtojca 2: Kronologjia e Momenteve Kryesore	35

Shkurtime

Shkurtimi	Përkufizimi
CAO	Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë (IFC dhe MIGA)
M&S	Mjedisor dhe Social
VMMS	Plani i Veprimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
SMMS	Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
ESRS	Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social
ESRP	Procedurat e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
MW	Megavatt
SP	Standardet e Performancës
PAPI	Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara
PIP	Përmbledhje e Investimit të Propozuar
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje Ekzekutive

Ky hetim i CAO rreth përputhshmërisë i përgjigjet një ankese të Qershorit 2015 nga Shoqata e Bujqësisë Organike, në emër të dy anëtarëve të komunitetit, në lidhje me ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit të hidrocentralit të Lengaricës (“HEC Lengarica”) në Shqipëri. HEC Lengarica u financuar pjesërisht nga IFC.

Në Shtator 2011, Bordi i IFC miratoi investimin kapitali deri në 6 milionë euro (ekuivalenti i 8.66 milionë dollarë amerikanë) në enso hidro energji sh.p.k. (“enso Shqipëri”), një kompani aksionere shqiptare e themeluar nga menaxheri austriak i aseteve enso hydro GmbH (“klienti”). Investimi përfaqëson deri në 20% të kapitalit në enso Shqipëri. Klienti synonte të investonte rreth 100 milionë euro në projekte hidrocentralesh të vogla në Shqipëri, me një kapacitet total të instaluar deri në 50MW. Në momentin e investimit të IFC, klienti kishte në ndërtim dy projekte hidrocentralesh në Shqipëri, Lengarica dhe Mati.

HEC Lengarica është një hidrocentral me kapacitet 8.9 MW me rrjedhje të lirë të lumit, i ndërtuar në pjesën e poshtme të lumit të Lengaricës, një degë e lumit të Vjosës në rrethin e Përmetit në Shqipërinë e jugut. Diga e HEC Lengarica është e vendosur rreth 7 km nga lumi i Vjosës. HEC Lengarica përbëhet nga një rregullator, një tunel 4 km, një rezervuar, një vepër marrëse uji 3.7 km, një central elektrik, dhe një linjë transmetimi prej 6.5 km deri tek nënstacioni i Përmetit. Centrali elektrik është i vendosur 2 km mbi lumin e Vjosës, në veri të fshatit Petran.

Një ankesë e Qershorit 2015 drejtuar CAOs ngriti akuzat e mëposhtme në lidhje me investimin e IFC në enso Shqipëri, dhe ndikimin mjedisor dhe social të HEC Lengarica:

- Moszbatimi nga IFC i politikave dhe standardeve M&S të veta, veçanërisht një due diligence (kujdes i duhur) i pamjaftueshëm; dhe kërkesat e Standardit të Performancës 6 (Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore) në lidhje me habitatet natyrore dhe kritike, dhe zonat e mbrojtura me ligj.
- Ndikimet negative mbi jetesën e bazuar në turizëm si një rezultat i ndërtimit të projektit, veçanërisht ndikimin e tij mbi aktivitetet ujore dhe peizazhet natyrore me vlerë turistike dhe kulturore.
- Mos-përputhshmëri me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm në lidhje me (a) vendndodhjen e projektit brenda Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli*, një zonë e mbrojtur; (b) ndikimet negative mbi monumentet natyrore për të cilat zbatohet niveli i parë i mbrojtjes sipas legjislacionit kombëtar; dhe (c) procesin e dhënies së lejeve mjedisore.
- Angazhim i pamjaftueshëm me palët e interesuara dhe shpërndarje e pamjaftueshme e informacionit.

Ky hetim i përputhshmërisë ofron një analizë dhe gjetje që lidhen me shqyrtimin dhe mbikëqyrjen nga IFC të HEC Lengarica rreth katër grupeve të çështjeve që ngrihen në ankesë:

- a) Ndikimet mbi speciet e rrezikuara dhe habitatet natyrore/kritike;
- b) Ndikimet mbi shërbimet e ekosistemit, në veçanti vlera ekoturistike e lumit të Lengaricës;
- c) Ndikimet mbi zonat e mbrojtura dhe monumentet natyrore; dhe
- d) Publikimi i informacionit, këshillimi dhe angazhimi i palëve të interesuara.

Hetimi i CAO merr në shqyrtim performancën e IFC përkundrejt kërkesave të Standardeve të Performancës (SP) she kërkesave të tjera të politikës së IFC që lidhen me çështjen. Ai gjithashtu merr në konsideratë faktin nëse projekti ka pasur rezultate të verifikueshme negative mjedisore dhe/ose sociale.

Ky raport ka gjetur që ka pasur mangësi materiale në shqyrtimin para-investimor nga IFC të projektit, por këto janë përgjithësisht korrigjuar gjatë mbikëqyrjes. Çështje të hapura që u

identifikuar në shqyrtimin e përputhshmërisë nga CAO lidhen me: (a) publikimin e informacionit të vlerësimit dhe monitorimit M&S për HEC Lengarica; (b) vlerësimin dhe zbutjen e ndikimeve të projektit mbi turizmin; dhe (c) përputhjen e HEC Lengarica me planin e menaxhimit për Parkun Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli*, brenda të cilit ai është vendosur.

Duke filluar me ndikimet e supozuara mbi biodiversitetin, CAO gjen që shqyrtimi M&S nga IFC ka anashkaluar një numër mangësish në vlerësimin nga klienti të rreziqeve dhe ndikimeve të HEC Lengarica. Këto përfshijnë gabime dhe lënie jashtë në VNMS e klientit që lidhen me: (a) identifikimin e llojeve të rrezikuara dhe endemike; (b) një mungesë vlerësimi të ndikimeve të grumbulluara (kumulative) që rrjedhin nga ndërtimi i hidrocentraleve të shumëfishtë mbi sistemin lumor të Lengaricës; dhe (c) mungesën e vlerësimit të mjaftueshmërisë së rrjedhës ekologjike. Megjithatë, këto mangësi në shqyrtimin e IFC u trajtuan gjatë zbatimit të projektit meqenëse u porositën studime shtesë të biodiversitetit dhe u ngrit një program i monitorimit të biodiversitetit. Rezultatet e monitorimit deri më sot nuk sugjerojnë që ndërtimi i HEC Lengarica të ketë sjellë ndikime negative të matshme mbi biodiversitetin. Në këto rrethana, CAO gjen që mbikëqyrja nga IFC ka qenë e përshtatshme.

Çështja e vendndodhjes së HEC Lengarica brenda Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli*, gjithashtu nuk është shikuar në kohën kur IFC miratoi investimin në vitin 2011. Megjithatë, pasi çështja u ngrit nga palët e interesuara në vitin 2014, IFC ndërmori hapa për tu siguruar që klienti ka marrë lejet e nevojshme për ndërtimin dhe shfrytëzimin e HEC Lengarica. Ndërkohë që ankuesit kundërshtojnë ligjshmërinë e procesit të dhënies së lejeve, këto çështje janë jashtë fushëveprimit të një shqyrtimi të përputhshmërisë nga CAO. Megjithatë, vendndodhja e HEC Lengarica brenda një Parku Kombëtar vë në lëvizje dispozitën e zonës së mbrojtur sipas SP 6, dhe CAO gjen që kërkohet mbikëqyrje shtesë për të siguruar që aktiviteti dhe programet e klientit janë në përputhje me planin e menaxhimit të Parkut.

Ndikimet e HEC Lengarica mbi turizmin u vunë në dukje në shqyrtimin para-investimor të IFC, por IFC nuk u sigurua që ato ishin vlerësuar dhe zbutur në përputhje me kërkesat e SP1 apo SP6 përpara ndërtimit të projektit. Mbikëqyrja pasuese nga IFC e HEC Lengarica konfirmon ndikimet e projektit mbi disa lloje të aktiviteteve të ekoturizmit, veçanërisht lundrimi me kajak në Kanionin e Lengaricës. Megjithatë, në lidhje me këto ndikim, IFC nuk ka siguruar konsultim të mjaftueshëm me palët e interesuara apo që masat e përshtatshme për të minimizuar, zbutur dhe/ose mënjanuar ndikimet të përfshiheshin në PVMS siç kërkohet nga SP1.

Zbatimi i kërkesave të IFC për publikimin e informacionit, konsultimin dhe angazhimin e palëve të interesuara për HEC Lengarica është i paplotë. Konsultimi i palëve të interesuara gjatë fazës së projektimit të HEC Lengarica ishte i kufizuar. Si pasojë, IFC punoi me klientin për të përgatitur një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara që dokumentoi angazhimet e klientit me grupe më të gjera të palëve të Interesuara gjatë periudhës 2013 – 2015. Në kundërshtim me kërkesat e SP1 dhe politikën e IFC për publikimin e informacionit, IFC nuk siguroi publikimin e VNMS të klientit të muajit Qershor 2011 mbi të cilin IFC bazoi shqyrtimin e saj M&S. Publikimi i dokumentacionit të mëtejshëm të vlerësimit dhe monitorimit M&S ka mangësi, si dhe informacioni në gjuhën vendase rreth rreziqeve dhe ndikimeve M&S të projektit.

Në dritën e gjetjeve që përmbahen në këtë raport i hetimit të përputhshmërisë, CAO do ta mbajë këtë hetim të hapur për monitorim, dhe do të nxjerrë një raport monitorimi jo më vonë se një vit pas publikimit të këtij hetimi. CAO do të monitorojë situatën deri sa veprimet e ndërmarra nga IFC të sigurojnë CAO-n që gjetjet e mos-përputhshmërisë janë adresuar.

Përshkrim i Përgjithshëm i Procesit të Përputhshmërisë të CAO

Përjasja e CAO ndaj mandatit të saj të përputhshmërisë është përcaktuar në Udhëzimet Operacionale të saj (Mars 2013).

Kur CAO merr një ankesë të pranueshme, në fillim ajo i nënshtrohet një vlerësimi për të përcaktuar se si duhet të përgjigjet CAO. Nëse vihet në lëvizje funksioni i përputhshmërisë, CAO do të kryejë një vlerësim të përfshirjes të IFC/MIGA në projekt dhe të përcaktojë nëse justifikohet kryerja e një hetimi. Funksioni i përputhshmërisë i CAO mund të vihet në lëvizje edhe nga Presidenti i Grupit të Bankës Botërore, Zëvendës Presidenti i CAO, apo drejtues të lartë të IFC/MIGA.

Hetimet e përputhshmërisë të CAO fokusohen në IFC/MIGA dhe se si IFC/MIGA janë siguruar rreth performancës të një projekti. Qëllimi i një hetimi të CAO mbi përputhshmërinë është të sigurojë përputhje me politikën, standardet, udhëzimet, procedurat dhe kushtet e përfshirjes së IFC/MIGA, dhe në këtë mënyrë për të përmirësuar performancën mjedisore dhe sociale (M&S) të institucionit.

Në kontekstin e një hetimi të CAO mbi përputhshmërinë, çështja është nëse:

- Rezultatet faktike M&S të një projekti janë në përputhje apo në kundërshtim me efektin e dëshiruar të dispozitave të politikave të IFC/MIGA;
- Një dështim nga IFC/MIGA për të adresuar çështjet M&S si pjesë e vlerësimit apo mbikëqyrjes rezultoi në rezultate në kundërshtim me efektin e dëshiruar të dispozitave politike

Në shumë raste, në vlerësimin e performancës së një projekti dhe zbatimi i masave për të plotësuar kërkesat përkatëse, është e nevojshme të shqyrtohen veprimet e klientit të IFC dhe të verifikohen rezultatet në terren.

CAO nuk gëzon autoritet në lidhje me proceset gjyqësore. CAO nuk është as gjykatë apeli dhe as një mekanizëm i zbatimit të ligjit, si dhe nuk është zëvendësues për sistemet e gjykatave ndërkombëtare apo sistemet gjyqësore në vendet pritëse.

Pas finalizimit të hetimit të përputhshmërisë, IFC/MIGA ka 20 ditë pune kohë për të përgatitur një përgjigje publike. Raporti i hetimit të përputhshmërisë, së bashku me ndonjë përgjigje nga IFC/MIGA, i dërgohet pastaj Presidentit të Grupit të Bankës Botërore për autorizim publikimi, pas të cilit raporti bëhet publik në faqen e internetit të CAO's (www.cao-ombudsman.org).

Në rastet kur IFC/MIGA gjendet që është jashtë përputhshmërisë, CAO e mban hetimin të hapur dhe monitoron situatën deri sa të ndërmerren veprime nga IFC/MIGA për të siguruar CAO që IFC/MIGA po e adreson mospërputhjen. Pastaj CAO do të mbyllë hetimin e përputhshmërisë.

1. Historiku

1.1. Investimi

1.1.1 Investimi i IFC në enso Shqipëri

Në Shtator 2011, Bordi i IFC miratoi investimin kapitali deri në 6 milionë euro (ekuivalenti i 8.66 milionë dollarë amerikanë) në enso hidro energji sh.p.k. (“enso Shqipëri”), një kompani aksionere shqiptare e themeluar nga menaxheri austriak i asetëve enso hydro GmbH (“klienti”).¹ Investimi përfaqësonte deri në 20% të kapitalit në enso Shqipëri.

Klienti synonte të investonte rreth 100 milionë euro në projekte hidrocentralesh të vogla në Shqipëri, me një kapacitet total të instaluar deri në 50MW. Këto projekte parashikoheshin si plotësues të mbështetjes së vazhdueshme për Qeverinë e Shqipërisë në forcimin e kuadrit rregullator të energjisë të rinovueshme në vend. Ai ishte gjithashtu në linjë me përqasjen e IFC ndaj zbutjes së ndryshimit të klimës. Në momentin e investimit të IFC, klienti kishte në ndërtim dy projekte hidrocentralesh në Shqipëri, Lengarica dhe Mati. Ishin parashikuar projekte të tjera, por nuk është raportuar asnjë në ndërtim në kohën e shkrimit të këtij raporti. Elementet shtesë të pritshme të IFC përfshinin: (a) zbutjen e rreziqeve rregullatore afat-gjata duke pasur parasysh historinë e kufizuar të sektorit të energjisë në Shqipëri; (b) ofrimin e vulës së miratimit në mbështetje të planit të investimit të klientit për të tërhequr investime të mëtejshme; (c) forcimi i sistemeve dhe politikave të menaxhimit M&S të klientit; dhe (d) krijimi i një partneriteti afatgjatë me klientin përmes një investimi kapital, duke përdorur përvojën e IFC në financimin e projekteve të prodhimit të energjisë në tregjet e derregulluar.²

1.1.2 Projekti i Hidrocentralit të Lengaricës

HEC Lengarica (“HEC Lengarica”) është një hidrocentral me kapacitet 8.9 MW me rrjedhje të lirë të lumit, i ndërtuar në pjesën e poshtme të lumit të Lengaricës, një degë e lumit të Vjosës në rrethin e Përmetit në Shqipërinë e jugut.

Diga e HEC Lengarica është e vendosur rreth 7 km nga lumi i Vjosës. Projekti i HEC Lengarica përbëhet nga një rregullator, një tunel 4 km, një rezervuar, një vepër marrëse uji 3.7 km, një central elektrik, dhe një linjë transmetimi prej 6.5 km deri tek nënstacioni i Përmetit. Centrali elektrik është i vendosur 2 km mbi lumin e Vjosës, në veri të fshatit Petran.

Harta e mëposhtme tregon vendndodhjen e HEC Lengarica, përbërësit e tij kryesorë, dhe monumentet natyrore që gjenden në zonë.

¹ IFC, Përmbledhje e Investimit të Propozuar, enso Albania, Shtator 2011 - <https://goo.gl/Xmzuec>

² *Ibid.*




Figura 1 – Projekti i Hidrocentralit të Lengaricës, Shqipëri
(Burimi: Grupi i Bankës Botërore)

HEC Lengarica fitoi një koncesion 35 vjeçar ndërtim-shfrytëzim-transferim (build-operate-transfer BOT) nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë në vitin 2008. Në Qershor 2011, klienti aplikoi për lejen mjedisore, e cila fillimisht u refuzua në Tetor 2011. Më vonë ai mori lejen në Janar 2012, pas dorëzimit të informacionit shtesë.

HEC Lengarica u ndërtua nga Lengarica & Energy sh.p.k. ("LaE"), një Subjekt për Qëllime të Veçanta (Special Purpose Vehicle - SPV) nën pronësinë e plotë të enso Shqipëri. HEC Lengarica gjithashtu mori mbështetje nga Banka e Zhvillimit e Austrisë (OeEB) dhe Green for Growth Fund ("GGF") si bashkëfinancues, si dhe Intesa Saopalo Bank.³ Ndërtimi i HEC Lengarica duke filluar në Korrik 2013, dhe shfrytëzimi filloi në Nëntor 2015.

1.2. Ankesa dhe Vlerësimi i CAO

Në Qershor 2015, Shoqata e Bujqësisë Organike dorëzoi një ankesë në CAO në emër të dy anëtarëve të komunitetit. CAO përcaktoi që ankesa ishte e pranueshme në Korrik 2015. Akuzat e ngritura nga ankuesit janë:

³ Klienti rifinancoi HEC Lengarica në Tetor 2017, me pjesëmarrjen e GGF dhe OeEB të parapaguar, dhe me borxhin e marrë përsipër nga dega lokale e Intesa Sanpaolo Bank.

- Moszbatimi nga IFC i politikave dhe standardeve M&S të veta, veçanërisht një due diligence (kujdes i duhur) i pamjaftueshëm; dhe kërkesat e Standardit të Performancës 6 (Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore) në lidhje me habitatet natyrore dhe kritike, dhe zonat e mbrojtura me ligj.
- Ndikimet negative mbi jetesën e bazuar në turizëm si një rezultat i ndërtimit të projektit, veçanërisht ndikimin e tij mbi aktivitetet ujore dhe peizazhet natyrore me vlerë turistike dhe kulturore.
- Mos-përputhshmëri me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm në lidhje me (a) vendndodhjen e projektit brenda Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli*, një zonë e mbrojtur; (b) ndikimet negative mbi monumentet natyrore për të cilat zbatohet niveli i parë i mbrojtjes sipas legjislacionit kombëtar; dhe (c) procesin e dhënies së lejeve mjedisore.
- Angazhim i pamjaftueshëm me palët e interesuara dhe shpërndarje e pamjaftueshme e informacionit.

Një vlerësim i ankesës u bë nga CAO në Nëntor 2015. Siç është përmbledhur në Raportin e Vlerësimit të CAO,⁴ kompania informoi që ata kanë ndërmarrë shqyrtimin e duhur (due diligence) për projektin e Lengaricës. Ata deklarojnë që koncesioni u dha përpara se zona të përcaktohej si një Park Kombëtar dhe venë në dukje që zona qendrore e parkut është rreth 9 km nga gjurma e HEC Lengarica. Ata pretendojnë që HEC Lengarica është projektuar të jetë në shkallë të vogël dhe shumë pak i dukshëm, me 95 për qind të ndërtimit nëntokë, dhe me ndikime mjedisore të kufizuara. Kompania deklaron që ata i kanë trajtuar çështjet e ngritura nga palët e interesuara lokale, siç është ndikimet mbi banjot termale, aksesin në ujë për ujitje dhe ndikimet mbi turizmin, duke ndërmarrë studime apo vendosur masa për t'i trajtuar këto çështje, për shembull përmes një plani rehabilitimi për të kthyer zonën në gjendje fillestare, duke ndërtuar një kanal për peshqit për të mundësuar migrimin e peshqve dhe rehabilitimin e monumenteve të kulturës. Ata raportojnë që studimet janë kryer, përfshirë një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe një hetim nga Ministria e Mjedisit ka arritur në përfundimin që ka ndikime të kufizuara ose nuk ka ndikime mjedisore nga HEC Lengarica.

Për sa i përket legjislacionit kombëtar, kompania pranon që pjesë të HEC Lengarica janë brenda Parkut Kombëtar, por që parku ka zona të përcaktuara ku disa aktivitete lejohen, dhe ata besojnë që projekti bie brenda këtyre zonave. Ata venë në dukje që HEC Lengarica ka një licencë të vlefshme mjedisore të lëshuar në Janar 2012.

Në lidhje me konsultimet me komunitetin, kompania deklaron që ata kanë organizuar takime publike dhe sesione informative, dhe kanë ftuar OJQ, njerëz të prekur dhe persona të tjerë të vizitojnë zonën e projektit të HEC Lengarica dhe të ndajnë shqetësimet e tyre. Ata raportojnë një përgjigje të kufizuar ndaj këtyre mundësive. Ata kuptojnë që ekziston mbështetje lokale për projektin dhe aktivitetin ekonomik që ai ka sjellë në zonë.

Pas një përpjekjeje për zgjidhje mosmarrëveshjeje, ankesa u transferua tek funksioni i përputhshmërisë i CAO në Shkurt 2016. Vlerësimi paraprak i përputhshmërisë i CAO, i muajit Maj 2016, arriti në përfundimin që çështjet e ngritura nga ankuesit justifikonin një hetim përputhshmërie të performancës së IFC në lidhje me këtë investim.⁵

⁴ Raporti i Vlerësimit të CAO, enso Shqipëri, Nëntor 2015 - <https://goo.gl/9ojM9P>

⁵ Raporti i Vlerësimit të Përputhshmërisë i CAO, enso Shqipëri, Maj 2016 - <https://goo.gl/t9TQeg>

1.3. Objekti dhe Metodologjia e Hetimit

1.3.1 Objekti i Hetimit të Përputhshmërisë

Ky hetim u krye në përputhje me Udhëzimet Operacionale të CAO (2013).⁶

Siç përcaktohet në Termat e Referencës (ToR) për këtë hetim të përputhshmërisë, hetimi merr në konsideratë nëse:

1. Shqyrtimi M&S Para-Investimor i IFC për HEC Lengarica, veçanërisht ndikimet e tij mbi biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit ishte në përpjestim të drejtë me rrezikun;
2. Shqyrtimi para-investimor i IFC i ka marrë në konsideratë siç duhet ndikimet e projektit mbi aktivitetet e jetesës bazuar në ekoturizëm;
3. IFC ka siguruar zbatimin e duhur të Standardit të Performancës 6 në HEC Lengarica, veçanërisht duke konsideruar vendndodhjen e projektit në një Park Kombëtar dhe praninë e llojeve të rralla dhe/ose të rrezikuara në zonë; dhe
4. IFC ka siguruar zbatimin e duhur të kërkesave të saj për konsultim dhe publikim për HEC Lengarica.⁷

Gjatë marrjes në konsideratë të performancës mjedisore dhe sociale në lidhje me këtë projekt, CAO ka qenë e ndërgjegjshme të mos presë performancë në një nivel të bazuar mbi informacion të marrë pasi kanë ndodhur ngjarjet. Në vend të kësaj, çështja është nëse ka fakte që IFC ka zbatuar kërkesat përkatëse duke pasur parasysh burimet e informacionit të disponueshme në atë kohë.

Mandati i CAO për përputhshmërinë fokusohet në performancën M&S të IFC. Në përputhje me Udhëzimet Operacionale të CAO, ky raport dokumenton gjetjet e hetimit në lidhje me përputhshmërinë e IFC me kërkesat përkatëse dhe rezultatet negative mjedisore dhe/ose sociale, përfshirë shkallën në të cilën këto janë të verifikueshme.

Si në gjithë rastet, objekti i hetimit përfshin arritjen e një kuptimi të shkaqeve të dukshme dhe të brendshme për çdo mospërputhshmëri të identifikuar nga CAO.

1.3.2 Metodologjia

Ky hetim përputhshmërie bazohet në një shqyrtim të dokumentacionit përkatës dhe diskutimeve me IFC, klientin, ankuesit dhe palë të tjera të interesuara. CAO ka kërkuar gjithashtu mendimin e një eksperti të jashtëm të biodiversitetit. Gjatë një vizite në Shqipëri në Nëntor/Dhjetor 2016, ekipi i hetimit të CAO takoi:

- Ankuesit;
- Dy përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të specializuar në mbrojtjen mjedisore të Lumit të Vjosës dhe në turizëm në zonën e HEC Lengarica;
- Përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri në nivele kombëtare dhe rajonale;
- Zyrtarë publikë të zonës së projektit;
- Menaxherët e klientit të IFC në nivel zyre qendrore dhe ekipin lokal në zonën e projektit.
- Kontraktorët e klientit me detyrë monitorimin mjedisor të HEC Lengarica;
- Një akademik shqiptar i specializuar në ruajtjen e biodiversitetit.

Vizita e CAO përfshiu një vizitë e mjedisëve të projektit dhe zonën përreth. Takimet u bënë personalisht dhe përmes telefonit përgjatë gjithë procesit të hetimit. Hetimi gjithashtu shqyrtoi materiale dytësore të ofruara nga palë të ndryshme të interesuara dhe informacion publik.

⁶ Udhëzimet Operacionale të CAO, 2013 - <https://goo.gl/XDr6pN>

⁷ Termat e Referencës të CAO për Hetimin e Përputhshmërisë, enso Shqipëri, 16 Qershor 2016 - <https://goo.gl/fr7Rd1>

1.3.3 Politika e Zbatueshme dhe Standardet e Performancës të IFC

Siç përcaktohet në Udhëzimet Operacionale (2013), CAO mbikëqyr hetimet e performancës M&S të IFC, duke siguruar përputhjen me politikën, Standardet e Performancës, udhëzimet dhe procedurat e IFC, shkelja e të cilave mund të sjellë rezultate negative mjedisore dhe/ose sociale (paragrafi 4.3)

Angazhimi i IFC për zhvillimin e qëndrueshëm është i shprehur në Kuadrin e Qëndrueshmërisë dhe përfshin Politikën e IFC mbi Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale (“Politika e Qëndrueshmërisë”); Standardet e Performancës (SP) të IFC, të cilat pritet të respektohen nga një klient përgjatë gjithë jetëgjatësisë së një investimi të IFC; dhe Politika për Publikimin e Informacionit. Vlerësimi mjedisor dhe social dhe udhëzimi mbikëqyrës i IFC për aktivitetet e investimit është përcaktuar në Procedurat e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social (ESRP).

Investimi i IFC në enso Shqipëri u bë në kontekstin e Kuadrit të Qëndrueshmërisë 2006. Investimi u miratua në kuadër të versionit 6.0 të ESRP dhe u mbikëqyr në kuadër të versioneve të mëvonshme të ESRP. Prandaj, CAO analizoi performancën kundrejt kërkesave të kuadrit të mësipërm.

Politika e Qëndrueshmërisë përcakton angazhimet e nivelit të lartë të IFC në kushtet e mëposhtëm, duke theksuar hierarkinë e zbutjes dhe një angazhim për të mos i transferuar kostot e projektit tek njerëzit që janë të varfër apo vulnerabël:

Me rëndësi thelbësore për misionin e zhvillimit të IFC janë përpjekjet e saj për kryerjen e operacioneve investimore dhe shërbimeve këshillimore të saj në një mënyrë që ‘nuk dëmton’ njerëzit apo mjedisin. Ndikimet negative duhet të shmangen aty ku është e mundur dhe, nëse këto ndikime janë të pashmangshme, ato duhet të reduktohen, zbuten apo kompensohen siç duhet. Veçanërisht, IFC është e angazhuar të sigurojë që kostot e zhvillimit ekonomik nuk bien në mënyrë të shpërpjesëtuar mbi personat e varfër apo vulnerabël, që mjedisi nuk degradohet në këtë proces, dhe që burimet natyrore menaxhohen me efikasitet dhe qëndrueshmëri. IFC beson që angazhimi i rregullt i klientit me komunitetet lokal rreth çështjeve që i ndikojnë ata drejtpërdrejt luan një rol të rëndësishëm në shmangjen apo reduktimin e dëmit ndaj njerëzve dhe mjedisit.⁸

Sipas Standardeve të Performancës dhe Politikës së Qëndrueshmërisë, përgjegjësia e IFC për mbikëqyrje M&S fillon përpara kryerjes së investimit në një kompani dhe vazhdon përgjatë gjithë periudhës së investimit. Në fazën përpara investimit, IFC shqyrton rreziqet dhe ndikimet M&S të një investimi të propozuar dhe bie dakord me klientin rreth masave për të zbutur këto rreziqe në përputhje me Politikën e Qëndrueshmërisë dhe Standardet e Performancës. Siç kërkohet nga Politika e Qëndrueshmërisë 2006, shqyrtimi M&S i IFC duhet të jetë “përshtatshëm me natyrën dhe shkallën e projektit” dhe “në përpjesëtim me nivelin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore” (paragrafi 13). Në kryerjen e shqyrtimit M&S, IFC merr në konsideratë rreziqet M&S siç vlerësohen nga klienti dhe “angazhimin e kapacitetin e klientit” për të menaxhuar këto rreziqe (paragrafi 15). IFC gjithashtu merr në konsideratë “historinë” e klientit në lidhje me çështjet M&S.⁹ Një parim kryesor i Politikës së Qëndrueshmërisë është që “IFC nuk financon aktivitete të reja biznesi nëse nuk pritet që ai të plotësojë Standardet e Performancës brenda një periudhe të arsyeshme kohe” (para.17).

Pas miratimit dhe investimit, IFC monitoron projektin për të siguruar përputhshmërinë me kushtet në marrëveshjet e investimit dhe politikën dhe standardet e zbatueshme të IFC. Siç përcaktohet në ESRP, “qëllimi i mbikëqyrjes M&S është të hartojë dhe mbajë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar statusin e përputhjes me Standardet e Performancës, Udhëzuesit e Shëndetit

⁸ Politika e IFC mbi Qëndrueshmërinë Social dhe Mjedisore, Prill 2006, paragrafi 8

⁹ ESRP 3, para.3.2.3, versioni 1, Prill 2006.

Mjedisor dhe Sigurisë të përgjithshme dhe specifike për sektorin, dhe Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS ose Plani i Veprimit)” për të cilat është rënë dakord me klientin.¹⁰ Politika e Qëndrueshmërisë 2006 përcakton gjithashtu që “nëse klienti nuk është në përputhje me angazhimet e tij sociale dhe mjedisore, siç shprehen në Planin e Veprimit të marrëveshjes ligjore me IFC, [IFC do të] punojë me klientin për ta kthyer në pozicion përputhshmërie deri në shkallën e arritshme, dhe nëse klienti dështon në rivendosjen e përputhshmërisë, do të ushtrojë zgjidhje aty ku është e përshtatshme” (paragraf 26).

1.4. Përshkrim i Përgjithshëm i Shqyrtimit dhe Mbikëqyrjes së Investimit nga IFC

1.4.1 Shqyrtimi Mjedisor dhe Social Para-Investimor i IFC

IFC kreu një vizitë vlerësuese në Shqipëri për investimin në enso në Qershor 2011, dhe e publikoi Përmbledhjen e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social (ESRS) për investimin në Gusht 2011.¹¹ IFC e përcaktoi investimin si Kategoria B, që do të thotë pritej të kishte ndikime të kufizuara negative sociale apo mjedisore, të cilat ishin të pakta në numër, përgjithësisht të lidhura me vendndodhjen, përgjithësisht të rikthyeshme dhe të trajtuara menjëherë përmes masave zbutëse.¹²

ESRS vë në dukje që shqyrtimi i duhur (due diligence) i IFC u fokusua në kapacitetin e klientit “për të ndërmarrë vlerësime të duhura të ndikimeve mjedisore dhe sociale dhe për të menaxhuar rreziqet dhe ndikimet [ESHS] që lidhen me blerjen, projektin inxhinierik, ndërtimin dhe shfrytëzimin e projekteve të energjisë ujore dhe objekteve që lidhen me to (p.sh. Rrugët hyrëse, linja e transmetimit), veçanërisht ato që lidhen me menaxhimin e ndërtimit, përcaktimin e rrjedhës ekologjike dhe zbutjen e ndikimit në biodiversitet; dhe konsultimi efektiv dhe angazhimi me komunitetet e prekura nga projekti.”¹³ Kjo përjasje u adoptua sepse klienti pritej të zhvillonte disa projekte të energjisë hidrike në Shqipëri, për të cilat ai duhej të zbatonte Standardet e Performancës të IFC. Në të njëjtën kohë, shqyrtimi i IFC përfshiu vizita në terren në dy projekte hidrocentrale që po merreshin në konsideratë nga klienti (Lengarica dhe Mati). Gjithashtu, IFC shqyrtoi dhe komentoi VNMS e Qershorit 2011 për HEC Lengarica.

1.4.2 Angazhimi dhe Plani i Veprimit M&S

Përshkrimi i investimit që u dorëzua në Bordin e IFC përpara miratimit të investimit përshkruan veprimet e mëposhtme si me rëndësi parësore për përputhshmërinë e HEC Lengarica me Kërkesat M&S të IFC:

- Monitorimi i rrjedhës ekologjike;
- Analizat alternative për të shmangur ndikimet mbi ujërat termale, urat e lashta dhe kanionin e Lengaricës; dhe
- Vlerësimi i vlerës së biodiversitetit i sistemit të lumit të Lengaricës dhe masat përkatëse zbutëse.

Një Plan Veprimi M&S (PVMS) u publikua në faqen e internetit të IFC së bashku me ESRS në Gusht 2011.¹⁴ PVMS përmbante veprime në nivelin e klientit të IFC, si dhe veprimet specifike për HEC Lengarica. Lidhur me HEC Lengarica, PVMS përfshiu kërkesat që klienti:

- Të zhvillonte dhe zbatonte Planin e Menaxhimit Mjedisor (PMM) dhe Planin e Menaxhimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social (PMMMS) (për tu hartuar përpara ndërtimit).
- Të mbante dhe monitoronte një rrjedhë ekologjike gjithë-vjetore prej 0.2 m³/s (raportim vjetor).

¹⁰ ESRP 6, para.1, versioni 5, 16 Gusht 2010.

¹¹ Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social e IFC, enso Shqipëri, 29 Gusht 2011 - <https://goo.gl/8V1RRR>

¹² Politika e IFC mbi Qëndrueshmërinë Social dhe Mjedisore, Prill 2006, paragrafi 18.

¹³ Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social e IFC, enso Shqipëri, 29 Gusht 2011 - <https://goo.gl/8V1RRR>

¹⁴ *Ibid.*

- To kryente një vlerësim shtesë të ndikimeve hidrogjeologjike, përfshirë ndikime mbi burimet gjeotermale (përpara disbursimit të parë nga IFC).
- Të kontraktonte një ekspert të pavarur të biodiversitetit për të hartuar dhe menaxhuar zhvillimin dhe zbatimin e një programi të fortë të monitorimit të biodiversitetit për të siguruar që ndikimet e HEC Lengarica mbi biodiversitetin janë minimizuar, përfshirë çështjet e lidhura me rrjedhën ekologjike, ujërat termalë dhe llojet endemike të “listës së kuqe” në rrezik zhdukjeje (për tu hartuar përpara disbursimit të parë të IFC dhe për tu raportuar çdo vit).

Bordi i IFC e miratoi investimin e propozuar në Shtator 2011, dhe një disbursim i parë u bë në Mars 2013.

1.4.3 Mbikëqyrja e Projektit

Mbikëqyrja nga IFC e investimit të saj në enso Shqipëri filloi në 2012 dhe është dokumentuar në shqyrtimet vjetore të raportimit të kompanisë në IFC dhe raportet e vizitave të mbikëqyrjes në terren. IFC kreu vizita mbikëqyrjeje në Shkurt 2014, Mars 2014; Maj, Shtator dhe Dhjetor 2016 dhe Prill 2017. Mbikëqyrja e IFC mori informacion dhe nga raportet e monitorimit të hartuar nga konsulentët mjedisorë të klientit, takimet e brendshme dhe telefonatat me klientin.

IFC dhe klienti, së bashku me huadhënësit e tjerë, ranë dakord që do të angazhohej një konsulent për të hartuar një program të monitorimit të biodiversitetit për HEC Lengarica. Konsulenti u kontraktua nga Finance in Motion (Green Growth Fund). Një Plan i Veprimit dhe Monitorimit Mjedor dhe Social (PVMMS) u përgatit nga konsulenti dhe u finalizua në Janar 2013. Konsulenti që përgatiti PVMMS ishte gjithashtu i ngarkuar me monitorimin e zbatimit të PVMMS gjatë gjithë jetëgjatësisë së projektit.

Ndërtimi i HEC Lengarica filloi në Korrik 2013, dhe projekti filloi shfrytëzimin në Nëntor 2015.

2. Analiza dhe Gjetjet

Ky seksion paraqet analizën dhe gjetjet nga CAO rreth përputhshmërisë. Ai merr në konsideratë shqyrtimin dhe mbikëqyrjen nga IFC të HEC Lengarica rreth katër grupeve të çështjeve që ngrihen në ankesë:

- e) Ndikimet mbi speciet e rrezikuara dhe habitatet natyrore/kritike;
- f) Ndikimet mbi shërbimet e ekosistemit, në veçanti vlera ekoturistike e lumit të Lengariçës;
- g) Ndikimet mbi zonat e mbrojtura dhe monumentet natyrore; dhe
- h) Publikimi i informacionit, këshillimi dhe angazhimi i palëve të interesuara.

Në lidhje me këto tema, seksioni përmbledh kërkesat përkatëse të IFC dhe ofron vlerësimin e CAO rreth zbatimit të projektit nga IFC.

2.1. Llojet e rrezikuara dhe habitatet natyrore/kritike;

Ankuesit pretendojnë që IFC dështoi që të siguronte që HEC Lengarica ishte në përputhje me Standardin e Performancës 6 (SP6) rreth Ruajtjes së Biodiversitetit dhe Menaxhimit e Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore, veçanërisht në lidhje me ndikimet e projektit mbi habitatet natyrore dhe kritike. Ankesa pretendon që projekti kërcënon ujërat termalë për shkak të aktiviteteve të ndërtimit. Ajo gjithashtu pretendon që largimi i ujit nga lumi kërcënon ekosistemin e një zone të mbrojtur, dhe se projekti do të ndikojë mbi proceset kryesore evolucionare në zonë. Për shkak të natyrës së projektit dhe shqetësimeve të ngritur në ankesë, CAO i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të mëposhtme:

- a) vlerësimi i ndikimeve të Lengaricës mbi llojet e rrezikuara dhe endemike;
- b) vlerësimi i ndikimeve kumulative mbi biodiversitetin; dhe
- c) metodologjia e përdorur për të përcaktuar rrjedhën minimale ekologjike e kërkuar për HEC Lengarica.

Çështjet e lidhura me vendndodhjen e HEC Lengarica në Parkun Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli* trajtohen në mënyrë të veçantë në seksionin 2.3 më poshtë.

Përmbledhje e Gjetjeve të CAO

Mangësitë në VNMS e klientit për HEC Lengarica u anashkaluan në shqyrtimin M&S para-investimor të IFC. Këto përfshinin: (a) mungesa e informacionit të përshtatshëm mbi llojet e rrezikuara dhe endemike në zonën e ndikimit; (b) mungesa e vlerësimit të ndikimeve kumulative duke marrë në konsideratë projekte të tjera hidrocentralesh që po zhvilloheshin në sistemin lumor të Lengaricës, veçanërisht HEC Pulita menjëherë mbi rrjedhë nga HEC Lengarica; dhe (c) mungesën e vlerësimit të mjaftueshmërisë së rrjedhës së propozuar ekologjike. Shqyrtimi i IFC nuk kërkoi vlerësime shtesë për të mbyllur këto mangësi, sic kërkohet nga Politika e Qëndrueshmërisë.

Në këtë kontekst, gjetja e CAO është që IFC nuk siguroi që klienti plotësonte kërkesën që “proces i Vlerësimit do të bazohet në informacionin aktual, përfshirë një përshkrim të saktë të projektit dhe të dhëna të përshtatshme të gjendjes fillestare sociale dhe mjedisore” (SP1, paragrafi 4).

Megjithatë, IFC i kërkoi klientit të kontrakttojë një ekspert të biodiversitetit për të hartuar dhe menaxhuar zbatimin e një programi të monitorimit të biodiversitetit. Megjithëse nuk ishte kërkuar nga IFC, klienti i dha për detyrë konsulentit të biodiversitetit kryerjen e një analize të hendekut mes VNMS dhe kërkesave të SP6. Si rezultat, u rekomanduan vlerësime shtesë të ndikimeve të projektit mbi biodiversitetin.

Gjatë mbikëqyrjes së IFC të HEC Lengarica, klienti kreu vlerësime shtesë. Ato adresuan mangësitë e identifikuara në VNMS 2011 në lidhje me ndikimet e mundshme mbi llojet e rrezikuara. Mbi bazën e informacionit të disponueshëm, përfundimi i IFC që projekti nuk ka ndikim mbi habitatet kritike është në linjë me kërkesat e SP6.

Ndërkohë që IFC kërkoi nga klienti që rrjedha ekologjike të monitorohet pasi HEC të vihet në punë, IFC nuk i kërkoi klientit të ndërmerre një vlerësim për të konfirmuar përshtatshmërinë e rrjedhës ekologjike të përlogaritur, duke mos zbatuar në këtë mënyrë kërkesat e Politikës së Qëndrueshmërisë, paragrafi 15. Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe vështirësitë e përcaktimit të vlefshmërisë së rrjedhës ekologjike, IFC inkurajoi klientin të përdorte një kuadër menaxhimi adaptiv. Rezultatet e monitorimit deri më sot nuk sugjerojnë që HEC Lengarica të ketë sjellë ndikime negative të matshme mbi biodiversitetin. Në këto rrethana, CAO gjen që mbikëqyrja nga IFC e çështjes së rrjedhës ekologjike ka qenë e përshtatshme.

2.1.1. Kërkesat e IFC

Kur merret në konsideratë një investim, shqyrtimi M&S i IFC merr parasysh “reziqet dhe ndikimet sociale dhe mjedisore të projektit siç vlerësohen nga klienti,”¹⁵ i cili ofron një bazë për vlerësimin e projektit nga IFC përkundrejt Standardeve të Performancës të saj. Në rastet kur vlerësimi M&S i klientit nuk është i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat e përcaktuara në Standardet e Performancës, “IFC i kërkon klientit të ndërmarrë Vlerësim shtesë apo, kur është e përshtatshme,

¹⁵ Politika e IFC mbi Qëndrueshmërinë Social dhe Mjedisore, Prill 2006, paragrafi 15

të kontraktoshme Vlerësim nga ekspertë të jashtëm.”¹⁶ Kjo mund të përfshijë vlerësimin e rreziqeve dhe ndikimeve kumulative në rastet kur është e përshtatshme.¹⁷

SP1 përcakton që vlerësimi M&S i projektit të jetë “një vlerësim i përshtatshëm, i saktë dhe objektiv” dhe “të bazohet në informacion aktual, përfshirë një përshkrim të saktë të projektit dhe të dhëna të përshtatshme bazë sociale dhe mjedisore.”¹⁸

Në rastet kur një projekt gjendet në zonat e një habitati natyror, SP6 kërkon që “klienti nuk do ta ndryshojë apo degradojë në mënyrë të konsiderueshme këtë habitat.”¹⁹ Nëse ky standard nuk mund të plotësohet, klienti duhet të demonstrojë:

- Nuk ka alternativa të zbatueshme nga ana teknike dhe financiare;
- Përfitimet e përgjithshme të projektit peshojnë më shumë se kostot, përfshirë kostot mbi mjedisin dhe biodiversitetin; dhe
- Çdo ndryshim apo degradim zbutet në mënyrë të përshtatshme.”²⁰

Aty ku është e arritshme, asnjë humbje neto biodiversiteti nuk duhet të ketë, dhe mund të përfshijë një numër strategjish zbutëse, siç janë:

- Rikthim habitati pas shfrytëzimit;
- Balancim i humbjeve përmes krijimit të zonave të krahasueshme ekologjikut, që menaxhohet për biodiversitetin; dhe
- Kompensim për përdoruesit e drejtpërdrejtë të biodiversitetit.²¹

Standarde më strikte zbatohen për projekte ndikojnë mbi habitate kritike, një nëngrup i habitatit natyror, i përcaktuar në SP6 si “zona me vlerë të lartë biodiversiteti”²², përfshirë habitatin që kërkohet për mbijetesën e llojeve të rrezikuara apo në rrezik kritik [dhe] zona që kanë rëndësi të veçantë për llojet endemike apo me shtrirje të kufizuar.”²³ Në këto zona, SP6 përcakton që: “Klienti nuk do të zbatojë ndonjë aktivitet të projektit deri në momentin që plotësohen kërkesat e mëposhtme:

- Nuk ka ndikime negative të matshme mbi aftësinë e habitatit kritik për të mbështetur popullatën e vendosur të llojeve... apo mbi funksionet e habitatit kritik...
- Nuk ka reduktim të popullatës të ndonjë lloji të rrezikuar apo në rrezik kritik
- Çdo ndikim i vogël zbutet...”²⁴

Dispozitat në lidhje me ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore që përmbahen në SP6 janë hartuar për “të shmangur apo zbutur kërcënimet ndaj biodiversiteti që vijnë nga ... operacione si dhe për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore.”²⁵ Zbatueshmëria e këtyre dispozitave vendoset gjatë procesit të Vlerësimit

¹⁶ Politika e IFC mbi Qëndrueshmërinë Social dhe Mjedisore, Prill 2006, paragrafi 15

¹⁷ Standardi i Performancës 1 i IFC, Prill 2006, para. 5: “Rreziqet dhe ndikimet do të analizohen në kontekstin e zonës së influencës së projektit. Kjo zonë influencë përfshin, sipas rastit: ... zonat që mund të ndikohen nga ndikime kumulative nga zhvillim i mëtejshëm i planifikuar i projektit, çdo projekt apo kusht ekzistues, dhe zhvillime të tjera që lidhen me projektin të cilat përcaktohen në mënyrë realiste në momentin kur ndërmerret Vlerësimi Social dhe Mjedisor”.

¹⁸ Standardi i Performancës 1 i IFC, Prill 2006, paragrafët. 4 dhe 7.

¹⁹ Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 7

²⁰ Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 7

²¹ Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 8

²² Siç janë zonat që plotësojnë kriteret e klasifikimit të Unioni Botëror i Ruajtjes (IUCN)

²³ Siç përcaktohet nga Lista e Kuqe e Llojeve të Kërcënuara të IUCN apo siç përcaktohen në ndonjë legjislacion kombëtar – Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 9

²⁴ Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 10

²⁵ Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 1

Social dhe Mjedisor të përcaktuar në SP1 dhe menaxhohet përmes Sistemit të Menazhimit Social dhe Mjedisor të klientit.

Përputhja me SP6 kërkon që “klienti ... të vlerësojë rëndësinë e ndikimeve të projektit mbi të gjithë nivelet e biodiversitetit”, me konsideratë për “vlerat e ndryshme që i bashkëngjiten biodiversitetit nga palë të interesuara specifike”.²⁶

2.1.2. Diskutime dhe Gjetje

Shqyrtimi Para-Investimor i Ndikimeve mbi Biodiversitetin nga IFC

Duke përmbledhur VNMS e klientit e Qershorit 2011, ESRS e IFC,²⁷ e botuar në Gusht 2011, vë në dukje që lumi i Lengaricës është një zonë me vlerë të lartë të biodiversitetit dhe që rreth 8 km të lumit do të kenë rrjedhë të reduktuar për shkak të HEC Lengarica. Rrjedha minimale e garantuar përshkruhet si 20% e rrjedhës minimale gjatë periudhave të thata, d.m.th. 200 litra në sekondë (ose 0.2m³/s). ESRS vë në dukje një gjetje nga VNMS se “rrjedha e mbetur ... mund të mbrojë funksione të ndryshme të lumit, duke ofruar habitate për bimët, jetën e egër dhe llojet ujore.”²⁸ ESRS konfirmon nevojën për një “program të fortë të menaxhimit të biodiversitetit”, si dhe studime shtesë hidrologjike për të forcuar VNMS në lidhje me ndikimet e mundshme mbi burimet e afërta termale. Këta zëra janë përfshirë në Planin e Veprimtimit M&S (PVMS) i rënë dakord me klientin. Megjithatë, përgjithësisht, përfundimi i IFC ishte që VNMS e klientit përfaqësonte “prantikë të mirë ndërkombëtare të sektorit”, dhe nuk kërkohej vlerësim shtesë në lidhje me ndikimet mbi biodiversitetin.²⁹

VNMS e klientit përmend praninë e llojeve të rrezikuara dhe/ose endemike në zonën e projektit. Megjithatë, CAO gjen që informacioni i ofruar është ose i paplotë, i pasaktë apo me mangësi në detaje në ato mënyra që do të kërkonin vlerësime shtesë në bazë të kërkesave të SP1 dhe SP6. Veçanërisht, CAO vë në dukje si më poshtë:

- VNMS identifikon praninë e “një numri të konsiderueshëm të llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore përgjatë lumit të Lengaricës (Ujërat Termale – Centrali i HEC)” bazuar në klasifikimin e IUCN³⁰. Si shembuj ai përmend *Sambucus nigra*, *Cladium mariscus*, *Ranunculus lingua*, *Salix triandra*, *Juglans regia*. VNMS gjithashtu vë në dukje praninë e “llojeve të rralla dhe të rrezikuara të faunës ... kryesisht amfibë,” duke renditur *Salamandra salamandra*, *Triturus vulgaris*, *Bufo bufo*, *Rana dalmatina*. Këta amfibë përshkruhen si “lloje të mbrojtura, të rrezikuara sipas IUCN.” Ndërkohë që CAO vë në dukje që asnjë nga këta lloje nuk janë të klasifikuar si të rrallë apo të rrezikuar nga IUCN,³¹ një numër i tyre raportohen si të mbrojtur në Shqipëri.³² Në lidhje me florën si dhe amfibët e renditur si të mbrojtur dhe të rrezikuar, VNMS arrin në përfundimin që do të ketë një kufizim të pjesshëm të habitatit për shkak të devijimit të ujit nga Lumi i Lengaricës.
- VNMS is referohet pranisë së një lloji të rrezikuar në mënyrë kritike në zonën e projektit, Ngjala Evropiane (*Anguilla anguilla*). Ajo përshkruhet si “një lloj i mirënjohur shtegtar që është i përhapur në të gjithë lumin e Vjosës dhe identifikuar brenda degës së Lengaricës”. CAO vë re që VNMS në mënyrë të pasaktë i referohet *Anguilla anguilla* që ka klasifikimin e IUCN “e rrezikuar” dhe jo klasifikimin më të ndjeshëm “rrezikuar në mënyrë kritike” që e ka pasur që në vitin 2008.³³

²⁶ Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 4

²⁷ Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social e IFC, enso Shqipëri, 29 Gusht 2011 - <https://goo.gl/8V1RRR>

²⁸ *Ibid.*

²⁹ *Ibid.*

³⁰ Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN)

³¹ Llojet e renditura ose nuk janë klasifikuar në Listën e Kuqe të IUCN ose klasifikohen si “Më Pak të Rrezikuara”.

³² FAO, Vlerësimi i Burimeve Pyjore Globale, 2005 – <https://goo.gl/ZUZUC>

³³ Shikoni Listën e Kuqe të IUCN, klasifikimi për *Anguilla anguilla* (Ngjala Evropiane) - <https://goo.gl/2hxVZz>

- VNMS deklaroi që ndërtimi i një projekti tjetër të energjisë hidrike (HEC Kalivaç) 70 km poshtë rrjedhës nga HEC Lengarica do të reduktojë habitatin e shumë llojeve ujore endemike dhe shtegtare. Ai vë re më tej praninë e disa llojeve endemike që jetojnë në kushte stresuese natyrore për shkak të kripësisë së lartë të ujit. Megjithatë, këto deklarata nuk janë përpunuar më tej dhe nuk ka ndonjë informacion se cilave lloje endemike i referohet.

Një diçka tjetër që është lënë jashtë shqyrtimit të IFC është ndërtimi i HEC Pulita sipër rrjedhës nga HEC Lengarica. Ndërkohë që nuk diskutohet në VNMS, dokumentacioni teknik i përgatitur si pjesë e vlerësimit të IFC përmendte HEC Pulita, duke deklaruar që po ndërtohej menjëherë sipër rrjedhës nga projekti i Lengaricës. Një shqyrtim i imazheve satelitore të disponueshme konfirmon që ndërtimi i HEC Pulita ishte i dukshëm në Shtator 2012 me vendndodhjen e kanalit të shkarkimit të HEC Pulita rreth 60 metra mbi rrjedhë nga diga e HEC Lengarica. Megjithatë, shqyrtimi M&S Para-Investitor i IFC nuk e përmendi HEC Pulita dhe as nuk kërkoi një vlerësim të ndikimeve kumulative.

Në lidhje me rrjedhën ekologjike të kërkuar për të ruajtur ekosistemin e lumit të Lengaricës, ESRS e IFC vë në dukje që VNMS për HEC Lengaricën nxori një rrjedhë ekologjike minimale prej 0.2m³/s. Megjithatë, ai ofroi mbështetje të kufizuar për përfundimin që kjo ishte një rrjedhë minimale e përshtatshme nga këndvështrimi i ruajtjes së biodiversitetit.

Në përmbledhje, ndërkohë që VNMS 2011 e vë në dukje praninë e llojeve endemike dhe të rrezikuara në zonën e projektit, ai nuk ofron informacion mbi këto çështje me saktësinë dhe hollësitë që do të priteshin në një VNMS në përputhje me Standardet e Performancës. VNMS i mungon analiza e ndikimeve kumulative siç kërkohet në një kontekst ku projekte të tjera hidrocentralesh po ndërtohen në të njëjtin sistem lumor me një projekt të financuar nga IFC. VNMS i mundon gjithashtu analiza për të mbështetur përfundimet mbi mjaftueshmërinë e rrjedhës ekologjike minimale të propozuar.

Çështjet e mësipërme ngrenë pyetje rreth cilësisë së VNMS. Megjithatë, IFC arriti në përfundimin që HEC Lengarica kishte një “VNMS të praktikës së mirë ndërkombëtare të sektorit” dhe nuk kërkoi ndonjë vlerësim të mëtejshëm të ndikimeve të projektit mbi biodiversitetin. IFC kërkoi më mirë që klienti të zhvillonte një program të monitorimit të biodiversitetit për të konfirmuar që ndikimet e HEC Lengarica mbi biodiversitetin ishin minimizuar.³⁴ Megjithëse është i rëndësishëm për të kuptuar ndikimet e projektit gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit, zhvillimi i një programi monitorimi nuk zëvendëson vlerësime të mjaftueshme paraprake siç kërkohet nga SP1, paragrafët 4-6.

Në këtë kontekst CAO gjen që shqyrtimi para-investitor i IFC nuk ishte i mjaftueshëm për të siguruar që klienti kishte kryer një vlerësim të ndikimeve të projektit mbi biodiversitetin që plotëson kërkesat e SP1 dhe SP6. Në mungesë të një vlerësimi të mjaftueshëm të ndikimeve, përfshirë të dhënat bazë sociale dhe mjedisore, CAO gjen që IFC nuk ishte në një pozicion për të përcaktuar masat zbutëse të nevojshme që HEC Lengarica të plotësonte kërkesat e IFC. Siç diskutohet më poshtë, këto çështje u adresuan në shkallë të ndryshme në vlerësimet e mëvonshme të kontraktuara nga klienti në bashkëpunim me GGF, por ato u anashkaluan nga IFC në fazën e shqyrtimit para-investitor.

Vlerësim shtesë i porositur nga klienti

Siç vihet në dukje më sipër, IFC dhe klienti ranë dakord që klienti do të kontraktonte një konsulent për të hartuar një program të monitorimit të biodiversitetit. Megjithatë, pasi u kontraktua nga klienti dhe GGF në 2012, objekti i punës për konsulentin e biodiversitetit u zgjerua për të përfshirë përgatitjen e një “Raporti të Biodiversitetit”. Objektivi i Raportit të Biodiversitetit ishte për të

³⁴ Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social e IFC, enso Shqipëri, i disponueshëm në <https://goo.gl/bMqJvF>

identifikuar dhe mbyllur në VNMS e Qershorit 2011 për HEC Lengarica në lidhje me biodiversitetin, siç kërkohet nga Standardi i Performancës 6. Raporti i Biodiversitetit i përfundua në Maj 2012.

Raporti i Biodiversitetit konfirmon një numër boshllëqesh në VNMS për HEC Lengaricën, duke vënë në dukje që habitatet e ndjeshme të ndikuar nga HEC Lengarica nuk ishin klasifikuar, përshkruar apo hartëzuar. Ai gjithashtu vë në dukje që llojet e pranishme në zonën e projektit nuk ishin vlerësuar plotësisht, dhe që habitatet për llojet e kërcënuara brenda zonës së projektit nuk u identifikuan apo përshkruan. Ai vë në dukje që të dhënat bazë nuk ishin të mjaftueshme për të parashikuar apo përcaktuar sasinë e ndikimeve të projektit, dhe komenton mbi mungesën e analizës në mbështetje të rrjedhës ekologjike të propozuar. Në përmbledhje, raporti arrin në përfundimin që kërkoheshin vlerësime shtesë të biodiversitetit për të trajtuar boshllëqet e konsiderueshme të identifikuar në VNMS. Këto përfshinin: (a) monitorimin e peshqve për të dhënë informacion rreth rrjedhës ekologjike të kërkuar; (b) një studim të mishngrënësve të mëdhenj; (c) një studim të shumimit të zogjve; dhe (d) një shqyrtim të ndikimeve të projektit mbi integritetin ekologjik të Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli*.

Studimet e rekomanduara në raport u përfunduan gjatë vitit 2012 dhe dhanë informacion për përgatitjen e një Plani i Veprimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social (PVMMS) për HEC Lengarica.³⁵ PVMMS u hartua për të konsoliduar masat e zbutjes të nevojshme për të shmangur ndikimet negative M&S dhe për të qenë në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të klientit, përfshirë Standardet e Performancës të IFC. Konsulenti i biodiversitetit kishte detyrën për përgatitjen e monitorimit të PVMMS mbi bazën e raportimit nga klienti dhe vizitave në terren. Bazuar në vlerësimet shtesë dhe masat e zbutjes të përfshira në PVMMS, nuk priteshin ndikime negative të mbetura të konsiderueshme mbi biodiversitetin.

Habitatet kritike dhe llojet endemike

IFC i raportoi CAO-s që përfundimet e VNMS 2011 dhe studimet e mëvonshme të porositura nga klienti ishin që HEC Lengarica nuk ka ndikim mbi habitate kritike siç përcaktohet në SP6. IFC gjithashtu vuri në dukje që ngritja e një programi të monitorimit të biodiversitetit të hartuar për të siguruar që vlerat e biodiversitetit në shtrirjen e lumit me rrjedhë të reduktuar nuk janë ndikuar negativisht.

Në lidhje me kërkesat e SP6 që kanë të bëjnë me habitatin kritik për ngjalën evropiane, dhe në përgjigje të pretendimeve të ankuesve, IFC i raportoi CAO-s që nuk beson se në këtë rast plotësohen kriteret, siç janë:

- shtrirja gjeografike (habitati) për ngjalën evropiane është e madhe;
- megjithëse që lumi i Lengaricës futet në këtë shtrirje, vetëm 3 specimene janë kapur gjatë katër studimeve të ndërmarra deri në 2016, nga të cilat dy u bënë afër bashkimit të Lengaricës me Vjosën, një zonë në pjesën poshtë rrjedhës nga kanali i shkarkimit të HEC Lengarica.
- studimet e monitorimit (2015) arritën në përfundimin që prania e ulët shpjegohet pasi të krahasohet me kanalin kryesor lumor (Lumi i Vjosës). Duket që popullata e ngjalës evropiane në Vjosë ka të ngjarë të jetë e konsiderueshme, por jo në Lengaricë për shkak të pengesave fizike dhe kimike të lumit, siç janë burimet termale.

Si e tillë, IFC arriti në përfundimin që zona e influencës e HEC Lengarica nuk mbivendoset me zonën gjeografike që mund të përbënte një kriter habitatit kritik për ngjalën evropiane.

Raporti i Biodiversitetit i vitit 2012 nga klienti nuk adreson drejtpërdrejt nevojën për hetim të mëtejshëm të deklaratave të përgjithshme në VNMS 2011 në lidhje me praninë e llojeve endemike

³⁵ Shikoni ERM, Plani i Veprimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social, Hidrocentrali i Vogël i Lengaricës, <https://goo.gl/1vzfZ8>

në zonën e projektit. Megjithatë ai as nuk tregon që llojet endemike janë të pranishme në zonën e projektit, apo të identifikojë ndikimet e projektit mbi llojet endemike.

Në këtë kontekst, CAO gjen që mbikëqyrja e IFC ndërmori hapat e duhur për tu siguruar që klienti menaxhoi rreziqet në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit në përputhje me kërkesat e SP6 për habitatet kritike. Në këndvështrimin e CAO-s, këndvështrimi i IFC që habitatit kritik nuk duhet të përdoret për ngjalën evropiane është në linjë me përkufizimin e habitatit kritik sipas SP6, paragrafi 9.

Rrjedha ekologjike

Rrjedhat ekologjike përshkruajnë sasinë dhe cilësinë e rrjedhës së ujit për të ruajtur ekosistemet lumore. Ekziston një literaturë e konsiderueshme mbi metodologjinë e praktikës së mirë për të llogaritur rrjedhat ekologjike, përfshirë nga Banka Botërore dhe IFC.³⁶

Raporti i klientit në 2012 mbi Mishngrënësit e Mëdhenj, Lakuriqët e Natës dhe Zogjtë Grabitqarë vë në dukje që uji i pamjaftueshëm në Kanionin e Lengaricës do të ndikojë mbi ekologjinë e lumit dhe kafshët e egra të tij. Raporti vë në dukje që ofrimi i një rrjedhe ekologjike minimale të shoqëruar me monitorimin e ndikimeve është i nevojshëm për të zbutur këtë ndikim të mundshëm mesatar deri të rëndë. Studimi i Peshqve 2012 i klientit gjithashtu vë në dukje që periudhat me rrjedhë të ulët janë kritike për mbijetesën dhe riprodhimin e peshqve në lumin Lengarica. Ai rekomandon si synim shkarkimin 0.2m³/s të përcaktuar në VNMS. Kjo është në linjë me përfundimin e konsulentit të klientit për biodiversitetin që rrjedha ekologjike minimale e propozuar prej 0.2m³/s ishte brenda diapazonit të besueshëm, por duhet të monitorohet për të siguruar përshtatshmërinë për kalimin e peshkut dhe hollimin e ujërave termalë.

Në lidhje me këtë, PVMMS kërkon: (a) përcaktimin e rrjedhën së kërkuar përpara ndërtimit ose mundësisht gjatë ndërtimit apo shfrytëzimit; dhe (b) monitorimi i rrjedhës ekologjike gjatë shfrytëzimit. Klienti më vonë kontraktoi një konsulent për të vlerësuar kushtet e rrjedhës dhe pasojat përkatëse mjedisore dhe për të propozuar një skemë monitorimi. Ky vlerësim u përfundua në Dhjetor 2015 dhe një raport final u hartua në Shkurt 2016, duke arritur në përfundimin që:

- Kushtet ekzistuese mjedisore në Lengaricë nuk janë të favorshme për llojet ujore - kjo është për shkak të presioneve kimike dhe termale si dhe karakteristikat gjeomorfologjike të lumit.
- Megjithatë në pjesët e lumit të prekur nga projekti gjenden peshq dhe lloje të tjerë.
- Llojet ujore do të ndikohen gjatë shfrytëzimit të HEC për shkak të efekteve mbi ekosistemin lumor në lidhje me rrjedhën e reduktuar (p.sh. Ndikime mbi cilësinë dhe disponueshmërinë e habitatit për shkak të thellësisë së reduktuar të ujit).
- Ndikime të mëtejshme do të vijnë nga hollimi i burimeve të ujërave termale me lumin e Lengaricës.. Përqendrimet e klorureve si dhe temperatura e ujit do të rriten në mënyrë të përhershme. Shkalla e dëmit ndaj llojeve ujore nuk mund të vlerësohet siç duhet, sepse përlllogaritjet dhe interpolimet janë subjekt i paqartësisë.
- Në dritën e mospërputhjes të të dhënave dhe kufizimeve të studimeve, ndikimet e mundshme gjatë shfrytëzimit mund të parashikohet vetëm me një farë pasigurie.
- Prandaj, do të jetë e nevojshme të vlerësohen ndikimet mjedisore përmes një programi afat-gjatë të plotë monitorimi gjatë shfrytëzimit.

Për të trajtuar nevojën për monitorim, konsulenti propozoi dhe u angazhua në kryerjen e një programi 2-vjeçar monitorimi të biodiversitetit. Kjo përfshiu shkarkimin e ujit, cilësinë dhe

³⁶ Shikoni Banka Botërore, Burimet Ujore dhe Mjedisi, Dokument Teknik C.1, Rrjedhat Ekologjike: Koncepte dhe Metoda, 2003 – <https://goo.gl/ewD5yG>; dhe Manuali i Praktikave të Mira të IFC, Rrjedhat Ekologjike për Projekte Hidrocentralesh, Shkurt 2018 – <https://goo.gl/nVD85b>

monitorimin e biodiversitetit ujon. Gjatë këtij programi 2-vjeçar, konsulenti përgatiti katër raporte monitorimi, në Gusht 2016, Dhjetor 2016, Gusht 2017 dhe Prill 2018.

Rezultatet e kësaj faze fillestare të monitorimit mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Kushtet para shfrytëzimit janë ndryshuar deri në një shkallë, megjithatë nuk janë zbuluar rreziqe të afërta ndaj biodiversitetit, të cilat do të kërkonin një përshtatje të rrjedhës ekologjike.
- Matjet e vazhdueshme dhe studimet treguan që thellësitë e duhura të ujit dhe sasi të shkarkimit janë vërtetuar në të gjithë stacionet e matjes. Prandaj, shtegtimi i peshqve ishte i mundur gjatë periudhës së monitorimit. Në ditët e nxehta të verës, një seksion i lumit ka të ngjarë të ketë pengesa për peshqit shtegtues, por ky ishte rasti dhe përpara shfrytëzimit.
- Faktorët abiotikë, d.m.th. përqendrimet e klorureve, temperatura e ujit (për shkak të shkarkimit të burimeve termale) dhe sedimentet janë faktorët mjedisorë më të prekur negativisht gjatë fazës së shfrytëzimit të HEC Lengarica. Ndërkohë që ndikimi i përqendrimeve të shtuara të klorureve është i paqartë dhe kërkon monitorim të mëtejshëm, ndryshimet e temperaturës së ujit u vlerësuan si të konsiderueshme.
- Rezultatet e studimit të dy viteve të monitorimit të peshqve tregojnë që të gjithë llojet kyç janë ende të pranishëm, dhe shpërndarja shfaqet e ngjashme me atë para shfrytëzimit. Në përgjithësi, u vëzhgova që lumi i Lengaricës ende ofron habitate të përshtatshme për riprodhim. Megjithatë, rekomandohet monitorim i mëtejshëm, meqenëse nivelet më të larta të temperaturës dhe përqendrimet e shtuara të klorureve mund të kenë ndikime potenciale negative mbi popullatën e peshqve.

CAO vë në dukje që PVMMS gjithashtu kërkoi një kanal për kalimin e peshqve tek diga, dhe monitorimin e kalimit të peshqve gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit. Kanali i peshqve u përfundua dhe u vu në punë në Tetor 2015. Programi i monitorimit vlerësoi efikasitetin e kanalit të peshqve. Raporti i monitorimit i klientit vuri në dukje që seksioni i lumit mbi digën e HEC Lengaricës ishte degraduar dhe shpesh i thatë, për shkak të pranisë së HEC Pulita, i cili nuk ofron një rrjedhë ekologjike. Programi i monitorimit arriti në përfundimin që shtegtimi i peshqve mbi digën e HEC Lengarica nuk ishte i favorshëm meqenëse nuk kishte habitate të përshtatshme menjëherë mbi rrjedhë.

Për ta përmbledhur, ndërkohë që pranon se HEC Lengarica do të ndryshojë dinamikën natyrore të lumit, IFC ka mendimin që një rrjedhë ekologjike e mjaftueshme për të mbrojtur funksionet ekologjike të lumit ishte e përcaktuar në VNMS dhe do të ruhej. Siç u vu në dukje më sipër, rrjedha ekologjike minimale prej 0.2m³/s e përshkruar në VNMS ishte përshkruar pa vlerësuar mjaftueshmërinë e regjimit të rrjedhës ekologjike të propozuar dhe as skenarët alternativë të rrjedhës. CAO gjen që Politika e Qëndrueshmërisë (paragrafi 15) kërkon vlerësime shtesë për të konfirmuar apo refuzuar rrjedhën ekologjike të propozuar në atë fazë.

Megjithatë, për shkak të kompleksitetit dhe vështirësive të konfirmimit të rrjedhës ekologjike, IFC inkurajoi klientin të adoptonte një kuadër adaptiv të menaxhimit. Kjo përfshinte monitorimin e ndikimeve mbi biodiversitetin të rrjedhës ekologjike të rekomanduar në VNMS. Programi i monitorimit i porositur nga klienti zbaton një metodologji të përshtatshme dhe mbulon treguesit e vlefshëm. Ndërkohë që monitorimi i vazhdueshëm konsiderohet i nevojshëm, rezultatet e deritanishme nuk sugjerojnë që HEC Lengarica të ketë sjellë ndikime negative të matshme mbi biodiversitetin. Në këto rrethana, CAO gjen që mbikëqyrja nga IFC e çështjes së rrjedhës ekologjike ishte e përshtatshme.

2.2. Ndikimi mbi Jetesën e bazuar në Turizëm

Ankuesit pretendojnë që HEC Lengarica po shkakton ndikime negative mbi jetesën e bazuar në turizëm, veçanërisht ndikime mbi aktivitetet ujore siç është lundrimi me kajak, vlerat turistike të monumenteve natyrore dhe kulturore të zonës dhe integritetin e burimeve termale të Benjës.

Përmbledhje e Gjetjeve të CAO

Në fazë para investimore, IFC nuk u siguroi që vlerësimi M&S i klientit për HEC Lengarica mori në konsideratë “vlerat e ndryshme që jepen ... nga palët të interesuara specifike, si dhe identifikimi i ndikimeve mbi shërbimet e ekosistemit” (SP6, paragrafi 4), veçanërisht ndikimet mbi ekoturizëm. Masat për të minimizuar, zbutur dhe/ose balancuar ndikimet e projektit mbi vlerën turistike të zonës nuk ishin përfshirë në PVMMS.

Mbikëqyrja pasuese nga IFC e HEC Lengarica konfirmon ndikimet e projektit mbi disa lloje të aktiviteteve të ekoturizmit, veçanërisht lundrimi me kajak në Kanionin e Lengaricës. Megjithatë, në lidhje me këto ndikime, IFC nuk ka siguruar konsultim të mjaftueshëm me palët e interesuara apo që masat e përshtatshme për të minimizuar, zbutur dhe/ose mënjanuar ndikimet të përfshiheshin në PVMS siç kërkohet nga SP1.

2.2.1. Kërkesat e IFC

SP6 përcakton që ndikimet mbi shërbimet e ekosistemit,³⁷ përfshirë shërbimet kulturore (p.sh. shlodhja dhe ekoturizmi, estetika, frymëzimi, vlerat edukative, vlera shpirtërore), të identifikohen gjatë procesit të Vlerësimit Social dhe Mjedisor.³⁸ Këto ndikime duhet “të analizohen në kontekstin e zonës së influencës së HEC Lengarica”,³⁹ e cila duhet të përcaktohet dhe përpunohet në konsultim me palët e interesuara të prekura. Kur konsiderohen këto ndikime, klientit “mund t’i duhet të konsultojë palët të interesuara kyç që, për qëllimin e Standardit të Performancës 6, përfshijnë komunitete që mund të preken, autoritete publike dhe ekspertë të pavarur”.⁴⁰

Masat dhe veprimet e hartuara për të trajtuar ndikimet e identifikuara mbi shërbimet e ekosistemit “do të anojnë nga shmangia dhe parandalimi i ndikimeve përkundrejt minimizimit, zbutjes apo kompensimit, sa herë është e arritshme teknikisht dhe financiarisht”. Aty ku rreziqet dhe ndikimet nuk mund të shmangen apo parandalohen, do të identifikohen masa dhe veprime zbutëse...⁴¹

2.2.2. Diskutime dhe Gjetje

Shqyrtimi M&S Para-Investimor i IFC

VNMS e klientit e Qershorit 2011 përfshin informacion që lidhet me shqetësimet e ankuesve rreth ndikimeve të HEC Lengarica mbi monumentet e natyrës dhe tërheqjes turistike të zonës. VNMS arrin në përfundimin që HEC Lengarica do të kufizojë rrjedhën e ujit në Kanionin e Lengaricës, një monument natyror sipas legjislacionit shqiptar, dhe që do të pakësojë vlerat e tij turistike dhe peizazhore. VNMS vë në dukje që Kanioni i Lengaricës frekuentohet nga turistë të cilëve u pëlqen turizmi malor dhe sportet ujore. Ai gjithashtu vë në dukje që burimet termale të Benjës njihen për vlerat kuruese, dhe që kanioni shkëmbor dhe shpella e pëllumbave në pjesën lindore të kanionit, janë tërheqje të famshme turistike.

³⁷ Sipas Shënimit Udhëzues 6 të IFC, paragrafi G4, shërbimet e ekosistemit janë “përfitimet që njerëzit marrin nga ekosistemet”

³⁸ Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 4

³⁹ Standardi i Performancës 1 i IFC, Prill 2006, para. 5

⁴⁰ Shënimit Udhëzues të IFC, Prill 2006, para. G4

⁴¹ Standardi i Performancës 1 i IFC, Prill 2006, para. 14

ESRS e pasqyron informacionin e mësipërm, duke vënë në dukje që lumi i Lengaricës ka një kanion natyror me vlerë të lartë të peizazhit natyror, dhe që kompania e ka projektuar projektin e Lengaricës për të shmangur ndikimet pamore në kanion, duke përfshirë burimet e afërta termale dhe urat e lashta. ESRS gjithashtu vë në dukje që është kryer një studim hidrologjik për të vlerësuar ndikimet e projektit mbi ujërat termale të Benjës. PVMMS kërkoi nga klienti të kryente një studim të përforcuar hidrologjik.

Në fazën e shqyrtimit para-investitor të IFC, CAO gjen që kishte nevojë për analizë të mëtejshme të rreziqeve dhe ndikimeve që lidhen me shërbimet e ekosistemit (përfshirë ndikimet mbi tërheqjen pamore dhe turistike të zonës) për të vlerësuar dhe zbutur këto ndikime. Megjithatë, CAO vëren që PVMMS nuk përmban masa zbutëse në lidhje me këto ndikime, dhe as nuk i kërkon klientit të ndërmarrë vlerësime për të kuptuar më mirë këto ndikime.

Mbikëqyrja e IFC

PVMMS identifikon ndikime të mundshme negative mbi ekoturizmin, duke cituar ujërat termale dhe udhëtimet me kajak si burime të ardhurash për tu vlerësuar për ndikimet. Duke pasqyruar këtë angazhim, klienti porositi një Vlerësim të Ndikimit mbi Turizmin në Mars 2013. Vlerësimi i Ndikimit mbi Turizmin arrin në përfundimin që HEC Lengarica do të ketë një ndikim të përgjithshëm pozitiv në zhvillimin e turizmit në zonë, meqenëse një pjesë e planit të investimeve komunitare të projektit synon të përmirësojë infrastrukturën e zonës si një pikë tërheqëse turistike. Megjithatë, ai vëren më tej që projekti do të ketë një ndikim negativ mbi disa aktivitete të turizmit, siç është udhëtimi me kajak në lumin e Lengaricës, i cili përfaqëson një tërheqje turistike të vogël por në rritje.

Në Shtator 2013, klienti përfundoi një Vlerësim të Ndikimeve mbi Peizazhin dhe Pamore, duke konfirmuar që HEC Lengarica do të pakësojë vlerat turistike dhe peizazhore të kanionit për një grup të ngushtë të receptorëve, d.m.th. turistët që pëlqejnë turizmin malor dhe sportet ujore. Ai vëren që meqenëse kanioni është pjesa më e largët e zonës për turistët, ndryshimet e mundshme të peizazhit (ndërtimi i një dige, rrjedhja e pakësuar e ujit në lumë) do të ndikojë vetëm një segment specifik të turistëve të cilët përfshihen në ngjitje, rafting dhe kajak.

Një raport i monitorimit të zbatimit të PVMMS, i përgatitur nga konsulenti M&S i klientit në 2013⁴² theksoi shqetësime të ngritura nga palë të interesuara lokale në lidhje me ndikimet e mundshme mbi turizmin, përfshirë shqetësimet e mundshme të burimeve termale të Benjës. Raporti vë në dukje pretendimet që nuk është bërë konsultim me zyrën e turizmit të Përmetit dhe që raporti i Vlerësimit të Ndikimit mbi Turizmin nuk u është shpërndarë kurrë palëve përkatëse të interesuara. Në 2014, konsulenti M&S i klientit dokumentoi shqetësime të mëtejshme në lidhje me ndikimet e projektit mbi turizmin, duke ngritur pyetjet mbi mundësinë e mbështetjes së aktiviteteve me kajak në lumë, dhe nëse nevojiteshin masa shtesë për shtegtimin. Në dokumentacionin e mbikëqyrjes së 2014, IFC përmend studimet e klientit rreth ndikimit mbi turizmin, duke vënë në dukje që projekti do të ketë ndikim minimal pamor mbi peizazhin. Megjithatë, nuk ka evidenca që IFC u siguroi që këto vlerësime të kryeshin, përfshirë konsultimin me palët e interesuara, sipas kërkesave të SP1 dhe SP6.

Në Maj 2016, klienti organizoi lëshimin e ujit për një grup përdoruesish të kajakëve në Lumin e Lengaricës, gjatë një vizite mbikëqyrjeje nga IFC. IFC u përfshi në organizimin e këtij aktiviteti dhe këshilloi klientin të shqyrtonte mënyrën se si të plotësonte kërkesat nga grupet e kajakëve në të ardhmen. Çështja e një aktiviteti të rregullt me kajakë në Lengaricë është theksuar në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesuara të klientit, megjithëse kjo nuk duket të ketë ndodhur.

CAO pranon që mbikëqyrja e IFC për HEC Lengarica e ka kapur çështjen e ndikimeve të projektit mbi shërbimet e ekosistemit, veçanërisht për sa i përket ekoturizmit dhe vlerës së përgjithshme

⁴² Nga informacioni në dispozicion të CAO, raporti nuk u përkthye në shqip.

turistike të zonës. Megjithatë, CAO gjen që IFC nuk është siguruar që kërkesat që klienti të bëjë konsultim dhe publikim informacioni ishin plotësuar në lidhje me vlerësimet e kryera gjatë mbikëqyrjes. SP1 kërkon nga IFC të sigurohet që palët e interesuara të jenë konsultuar dhe masat e përshtatshme zbutëse të jenë shtuar në PVMMS e Projektit.

2.3. Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Ankuesit theksojnë që HEC Lengarica nuk duhej të lejohej sipas legjislacionit shqiptar mbi zonat e mbrojtura, dhe nuk plotëson kërkesat e IFC në lidhje me zonat e mbrojtura, meqenëse është i vendosur brenda Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli*. Ankuesit gjithashtu ngrenë çështjen që HEC Lengarica ka pasur ndikime negative mbi monumentet e natyrës, përfshirë Kanionin e Lengaricës, Gurin e Petranit, shpellën e pëllumbave të Benjës, Urën e Kadiut dhe ujërat termale, të cilët gëzojnë nivelet më të larta të mbrojtjes sipas legjislacionit kombëtar.⁴³

Ankuesit venë në dukje që në Tetor 2011, Ministria e Mjedisit i refuzoi klientit autorizimin për HEC Lengarica, bazuar në vendndodhjen e tij brenda Parkut Kombëtar dhe në një zonë që është e mbrojtur për shkak të afërsisë së saj me monumentet e natyrës. Megjithatë, nuk kundërshtohet fakti që Ministria e Mjedisit më vonë e miratoi HEC Lengarica (në Janar 2012).

Përmbledhje e Gjetjeve të CAO

Shqyrtimi para-investimor i IFC nuk e identifikoi që HEC Lengarica të ishte i vendosur brenda Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli*. Si rezultat, IFC nuk vuri në veprim SP6, paragrafi 11, i cili përcakton kërkesat ndaj klientit kur ai planifikon një projekt në një zonë të mbrojtur ligjërisht. Po ashtu, IFC nuk mori në konsideratë çështjet e lidhura me zbatimin e ligjit shqiptar mbi zonat e mbrojtura.

Në vitin 2014, pasi u ngritën shqetësime publike në lidhje me vendndodhjen e HEC Lengarica në një park kombëtar, IFC shqyrtoi një mendim ligjor të porositur nga klienti. Kjo ofroi sigurinë që klienti kishte marrë lejet e nevojshme për ndërtimin e HEC Lengarica.

Megjithatë, CAO gjen që kërkohet mbikëqyrje e vazhdueshme për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e SP 6 në lidhje me: (a) përputhjen e HEC Lengarica me planet e menaxhimit të Parkut Kombëtar; dhe (b) konsultimin me palët e interesuara të zonës së mbrojtur.

2.3.1. Kërkesat e IFC

Standardi i Performancës 6 i IFC mbi Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Menaxhimin e Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore përcakton kërkesat kur një projekt operon në një zonë të mbrojtur.⁴⁴ Dispozitat e SP 6 kërkojnë që klienti (i) “të veprojë në një mënyrë në përputhje me planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur”, dhe (ii) “të konsultohet me mbështetësit dhe menaxherët e zonës së mbrojtur, komunitetet lokale dhe palë të tjera të interesuara rreth projektit të propozuar” (paragrafi 11). IFC gjithashtu u kërkon klientëve të saj të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.⁴⁵

⁴³ Sipas legjislacionit shqiptar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 676 (20.12.2002) shpalli monumentet natyrore të Shqipërisë si zona të mbrojtura. Monumentet e natyrës shpallen të tilla nga autoritetet shqiptare, dhe mund të jenë pemë specifike bazuar në përmasat dhe moshën e tyre; shpella dhe gurë në forma specifike; burime ujore me vlera të theksuara estetike dhe turistike.

⁴⁴ Një zonë e mbrojtur, për qëllimin e SP 6 është një zonë ligjërisht e mbrojtur për mbrojtjen apo ruajtjen e biodiversitetit (SP6, FN6).

⁴⁵ Standardet e Performancës të IFC, Hyrje, para. 3, 2006

2.3.2. Diskutime dhe Gjetje

CAO ka konfirmuar që zona ku HEC Lengarica është vendosur u shpall pjesë e Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli* kur ai u zgjerua në vitin 2008, disa vjet përpara se IFC të mernte në konsideratë një investim në projekt.⁴⁶ Megjithatë, IFC raportoi që ekipi i projektit nuk ishte në dijeni të vendndodhjes së HEC Lengarica brenda Parkut Kombëtar në kohën e shqyrtimit M&S para-investimor të IFC. Ndërkohë që VNMS e vitit 2011 i referohet vendimit të Qeverisë së Shqipërisë të vitit 2008 që e zgjeroi Parkun Kombëtar, ai nuk përfshin një hartë të Parkut dhe nuk specifikon vendin ku ndodhet HEC Lengarica në lidhje me kufijtë e tij. Në vend të kësaj, ai deklaron që projekti nuk “ndërhyn” në “zonat e mbrojtura” të afërta si Parku, që ekosistemi i lumit të Lengaricës nuk është një zonë e mbrojtur, dhe që nuk ka zona të mbrojtura pranë HEC Lengarica.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1631,⁴⁷ kufizimet e përdorimit për katër nënzonat e Parkut Kombëtar përfshijnë të mëposhtmet:

- **Zona qendrore** i përfshin habitatet kryesore natyrore të *Bredhi i Hotovës-Dangëlli* e përcaktuar si një zonë me vlera të larta të lidhura me natyrën dhe biodiversitetin. Në këtë nën-zonë zbatohet niveli i parë i mbrojtjes, i cili ofron një territor të pashqetësuar.
- **Zona e përdorimit të qëndrueshëm**, përfshihen habitate pyjore e kullosore, përreth zonës qendrore, për të cilën ajo shërben si zonë buferike. Lejohen veprimtaritë ekonomike sezonale (si kullotja, grumbullimi i bimëve mjekësore, prodhimeve të dytë të pyllit), të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit.
- **Zona rekreative**, përfshin një zonë me mundësi rekreative, në natyrë të hapur, në përputhje me funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike, të peizazhit dhe vlerat turistike e kulturore. Në këtë zonë përfshihen pjesët pyjore, livadhet dhe toka bujqësore në masivin pyjor të *Bredhit të Hotovës* dhe banjat termale.
- **Zona e përdorimit tradicional**, mundëson vazhdimin e veprimtarive tradicionale dhe ekonomike. Veprimtari të reja mund të ushtrohen, por vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi. Në këtë zonë, e cila është kryesisht e përdorur nga banorët, përfshihen territoret bujqësore, ujore, me bimësi pyjore, rreth qendrave të banuara.⁴⁸

Figura e mëposhtme tregon që HEC Lengarica shtrihet brenda zonës 2, 3 dhe 4 të Parkut Kombëtar.

IFC i raportoi CAO që për herë të parë u bënë të vetëdijshëm për çështjet që lidhen me Parkun Kombëtar në Nëntor 2014, pas protestave në Tiranë, d.m.th. gjashtë vjet pas zgjerimit të parkut dhe më shumë se një vit pas fillimit të ndërtimit të HEC Lengarica. Pastaj IFC e ngriti çështjen me klientin. IFC u takua me konsulentin i cili përgatiti PVMMS e HEC Lengarica për të kuptuar më mirë se çfarë do të thoshte vendndodhja e projektit në një zonë të mbrojtur. IFC i raportoi CAO që gjurma e HEC Lengarica është jashtë zonës qendrore të Parkut Kombëtar, dhe mbulon zona të përcaktuara për përdorim të qëndrueshëm, tradicional dhe rekreativ.

⁴⁶ Shikoni: Vendimi Nr. 1631 që shpall ekosistemin natyror *Bredhi i Hotovës-Dangëlli* si park kombëtar, 2008 - <https://goo.gl/EvDtAU>

⁴⁷ *Ibid.*

⁴⁸ Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës – Dangëlli, Shtator 2013 - <https://goo.gl/tjuqMe>




Figure 2 – Zonimi i Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës*
(Burimi: Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës – Dangëlli*)

Në Tetor 2014, ankuesit dorëzuan një letër në disa ministra, si dhe në zyrat e Bankës Botërore dhe IFC në Shqipëri, duke hedhur poshtë ligjshmërinë e HEC Lengarica. Letra paraqiti një numër argumentesh në lidhje me ndikimin e HEC Lengarica në Parkun Kombëtar dhe monumentet e afërta natyrore. Me rëndësi për çështjet e ngritura në ankesë, letra vë në dyshim ligjshmërinë e HEC Lengarica në bazën e Ligjit për Zonat e Mbrojtura (2002) i cili ndalon ndërtimin e rrugëve dhe linjave të tensionit të lartë në Parqet Kombëtare (Neni 6). Letra debaton që HEC Lengarica shkel kërkesat e Nenit 9 të Ligjit për Zonat e Mbrojtura i cili ndalon aktivitete që sjellin një ndryshim në gjendjen natyrore të rezervave ujore, burimeve ujore, liqeneve dhe sistemeve ligatinore. Ajo gjithashtu debaton që HEC Lengarica, veçanërisht në pakësimin e rrjedhës së ujit në lumin e

Lengaricës, dhe ndërtimin e një ure betoni pranë Urës historike të Kadiut, ka ndikime negative mbi monumentet e shpallura natyrore⁴⁹ dhe kulturore⁵⁰ që nuk lejohet sipas Ligjit për Zonat e Mbrojtura (neni 7) dhe Ligji për Trashëgiminë Kulturore (2003, Neni 38).

Ankuesit venë në dukje vendimin e Ministrisë së Mjedisit të Tetorit 2011 e cila refuzoi lejen për të ndërtuar HEC Lengarica bazuar në: (a) vendndodhjen e saj brenda Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës*; (b) pasjen e ndikimeve të konsiderueshme negative mbi Kanionin e Lengaricës, një monument natyror sipas Ligjit për Zonat e Mbrojtura; dhe (c) pasjen e ndikimeve të konsiderueshme negative mbi burimet termale të Benjës për shkak të devijimit të rrjedhës natyrore të lumit të Lengaricës.⁵¹

Një mendim i Nëntorit 2014 nga një firmë ligjore shqiptare, e kontraktuar nga klienti në përgjigje të këtyre pretendimeve, pranon që HEC Lengarica bie brenda tre zonave të Parkut Kombëtar të përshkruara më sipër. Mendimi i referohet vendimit të Janarit 2002 të Ministrisë së Mjedisit, me të cilin përmbysi vendimin e Tetorit 2011 dhe miratoi HEC Lengarica. Mendimi arrin në përfundimin që HEC Lengarica nuk është angazhuar në ndonjë aktivitet të ndaluar nga Ligji për Zonat e Mbrojtura Ai arrin në përfundimin që shqetësimet e ankuesve në lidhje me legjitimitetin e veprimeve nga autoritetet shtetërore në lëshimin e licencave dhe autorizimeve përkatëse nuk janë të bazuara.

IFC i raportoi CAO që ajo i shqyrtoi përfundimet e këtij mendimi ligjor pasi u bë e vetëdijshme për shqetësimet e ankuesve. Duke konsideruar zbatimin e SP6 paragrafi 11 në projekt, IFC arriti në përfundimin që (1) vetëm zona qendrore është përcaktuar qartësisht për mbrojtjen apo ruajtjen e biodiversitetit; dhe (2) kompania ka plotësuar kërkesat e saj në lidhje me konsultimet dhe monitorimin në vazhdim nga një konsulent i pavarur.

IFC i raportoi CAO që nuk kishte një plan të njohur menaxhimi për Parkun Kombëtar *Bredhi i Hotovës – Dangëlli*. Prandaj, këndvështrimi i IFC ishte që kompania mund të vepronte vetëm në një mënyrë që ishte në përputhje me përkufizimet e zonave të mbrojtura aty ku operon, gjë që IFC e konsideronte të bërë. Megjithatë, CAO gjeti që, megjithëse nuk kishte një plan menaxhimi në momentin e miratimit të projektit nga IFC në 2011, një plan menaxhimi për Parkun Kombëtar *Bredhi i Hotovës – Dangëlli* u përfundua në Shtator 2013⁵² dhe u miratua në Dhjetor 2014.⁵³

Përkatësisht, plani i menaxhimit e identifikon sektorin e energjisë hidrike si një kërcënim të mundshëm për tu monitoruar nga afër përmes verifikimit të zbatimit të saktë të masave zbutëse dhe kushteve të lejes mjedisore. Planin e menaxhimit thekson zhvillimin e turizmit me ndikim të ulët dhe aktivitetet rekreative. Ai gjithashtu vë në dukje angazhimin dhe vështirësitë burimore të realizimit të objektivave të ruajtjes së Parkut Kombëtar. Në diskutime me CAO, përfaqësuesit qeveritarë përgjegjës për administrimin e zonave të mbrojtura shprehën vështirësi në zbatimin efektiv të planit të menaxhimit, duke vënë theksin në barrën e sipërmarrjes dhe burimet e kufizuara për ta realizuar atë.

Për ta përmbledhur, në fazën para-investimore, IFC nuk e mori në konsideratë përputhshmërinë e HEC Lengarica me legjisllacionin kombëtar në lidhje me zonat e mbrojtura, dhe nuk e identifikoi vendndodhjen e HEC Lengarica brenda kufijve të Parkut Kombëtar *Bredhi i Hotovës – Dangëlli*. Megjithëse gjurma e HEC Lengarica nuk mbivendoset me zonën qendrore të Parkut, ai është

⁴⁹ Në mënyrë specifike Banjat Termale të Benjës, Kanioni i Lengaricës, Shpella e Pëllumbave, dhe Guri i Petranit

⁵⁰ Në mënyrë specifike Shpella e Pëllumbave dhe Urat e Katit dhe Dashit.

⁵¹ Vendim i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Tetor 2011 – <https://goo.gl/4DL4qt>

⁵² Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës – Dangëlli, Shtator 2013 - <https://goo.gl/tjuqMe>

⁵³ Qeveria e Shqipërisë, Ministria e Mjedisit, Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri, Dhjetor 2015, faqe 36 – <https://goo.gl/eXGhGp>

vendosur në zona që janë përcaktuar ligjërisht për ruajtjen e biodiversitetit, si rezultat i të cilës zbatohen dispozitat e SP 6 për zonat e mbrojtura.

Në vitin 2014, pasi u ngritën shqetësime publike në lidhje me vendndodhjen e HEC Lengarica në një park kombëtar, IFC shqyrtoi një mendim ligjor të porositur nga klienti. Kjo ofroi sigurinë që klienti kishte marrë lejet e nevojshme për ndërtimin e HEC Lengarica. Ndërkohë që ankuesit kundërshtojnë ligjshmërinë e procesit të dhënies së lejeve, këto çështje janë jashtë fushëveprimit të një shqyrtimi të përputhshmërisë nga CAO.

Për projektet të ndodhura brenda një zone të mbrojtur, roli i IFC përfshin gjithashtu sigurimin që klienti i tij po punon në një mënyrë që është në përputhje me ndonjë plan menaxhimi për zonën e mbrojtur (SP6, paragrafi 11). Kjo nuk është bërë meqenëse as IFC dhe as klienti i saj nuk ishin në dijeni të një plani menaxhimi të vitit 2013 për Parkun Kombëtar.

2.4. Publikimi i informacionit, këshillimi dhe angazhimi i palëve të interesuara

Ankuesit pretendojnë që kompania nuk i ka trajtuar mjaftueshëm shqetësimet lokale rreth HEC Lengarica, të shprehura nga anëtarët e komunitetit. Ata gjithashtu theksojnë që informacioni rreth projektit nuk u është shpërndarë palëve të interesuara në një mënyrë që është në përputhje me kërkesat e Standardeve të Performancës.

Përmbledhje e Gjetjeve të CAO

Në fazën para-investimore, CAO gjen që IFC nuk zbatoi kërkesat përkatëse të publikimit të informacionit. Në veçanti, (1) IFC nuk u siguroi që klienti “të publikojë dokumentin e Vlerësimit [dhe] Planin e Veprimit për komunitetet e prekura” (SP1 paragrafi 20), përfshirë VNMS e vitit 2011 mbi të cilin ka bazuar shqyrtimin e saj M&S; dhe (2) IFC nuk “ka vënë në dispozicion kopje elektronike, dhe aty ku është e disponueshme, lidhjet e internetit për ... dokumentet përkatëse të vlerësimit të ndikimeve sociale dhe mjedisore” (Politika e Publikimit, paragrafi 13).

Konsultimi para ndërtimit ishte kufizuar tek palët e interesit të ndikuara drejtpërdrejt nga blerja e tokës dhe aksesit në ujë, duke përjashtuar grupe më të gjera të palëve të interesuara siç janë ata që punojnë në sektorin e turizmit në zonë. IFC nuk siguroi që klienti ndërmori një proces konsultimi që tu ofronte këtyre grupeve “mundësi për të shprehur mendimin e tyre mbi rreziqet, ndikimet dhe masat zbutëse të projektit” (SP1, para. 21).

IFC nuk u siguroi që klienti plotësoi kërkesat e saj për publikim në lidhje me monitorimin M&S (PS1, paragrafi 26). Megjithatë, gjatë mbikëqyrjes së projektit, CAO pranon që IFC ka bërë përpjekje për të siguruar që klienti ka përgatitur një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara dhe ka shtuar angazhimin e saj me grupe më të gjera të palëve të Interesuara, siç janë operatorët turistikë.

2.4.1. Kërkesat e IFC

Politika e IFC mbi Publikimin e Informacionit kërkon që institucioni të “bëjë të disponueshme kopje elektronike, dhe aty ku është e mundur lidhje interneti, të çdo dokumenti përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis të përgatitur nga apo në emër të klientit, përfshirë Planin e Veprimit.”⁵⁴ Politika vë në dukje më tej që “ka një supozim në favor të publikimit në lidhje me informacionin [në lidhje me aktivitetet e mbështetura nga IFC], përveç rasteve kur ka një arsye detyruese për të mos e publikuar këtë informacion.”⁵⁵ Klienti është njësoj i detyruar të publikojë çdo dokument Vlerësimi dhe Plan Veprimi në rastet kur është e zbatueshme, dhe të ofrojë raporte periodikë që

⁵⁴ Politika e IFC mbi Publikimin e Informacionit, Prill 2006, paragrafi 13(a)

⁵⁵ Politika e IFC mbi Publikimin e Informacionit, Prill 2006, paragrafi 9

përshkruajnë progresin me zbatimin e Planit të Veprimit rreth çështjeve që përfshijnë rrezikun e vazhdueshëm apo ndikime mbi komunitetet e prekura, dhe për çështje që procesi i konsultimit ... i ka identifikuar si shqetësim për këto komunitete.”⁵⁶

Në përputhje me SP1, angazhimi i komunitetit duhet “të kryhet në bazë të informacionit të dhënë në kohë, të vlefshëm, të kuptueshëm dhe të arritshëm.”⁵⁷ IFC pret që klientët të konsultohen me komunitetet e prekura “në një mënyrë që u ofron ... komuniteteve mundësi për të shprehur mendimet e tyre mbi rreziqet, ndikimet dhe masat zbutëse të projektit, dhe i mundëson klientit t'i shqyrtojë dhe tu përgjigjet atyre.”⁵⁸ Klienti është përgjegjës për të siguruar që konsultimi “bazohet në publikim paraprak të informacionit të vlefshëm dhe të mjaftueshëm” dhe i përshtatur me “preferencën gjuhësore të komuniteteve të prekura.”⁵⁹

Kur veprojnë në një zonë të mbrojtur, SP6 kërkon nga klientët e IFC të “konsultojnë sponsorët dhe administratorët e zonës së mbrojtur, komunitetet lokale dhe palë të tjera të interesuara rreth projektit të propozuar.”⁶⁰

2.4.2. Diskutime dhe Gjetje

Shqyrtimi M&S Para-Investimor i IFC

Sipas kërkesave të Politikës për Publikimin e Informacionit të vitit 2006, ESRS e IFC vëren që IFC dhe klienti do të publikojnë: (a) informacion rreth menaxhimit të rreziqeve dhe ndikimeve sociale dhe mjedisore nga projektet dhe operacionet e kompanisë, (b) VNMS e përditësuar të Lengaricës (2011) dhe (c) PVMMS të datës 25 Gusht 2011.⁶¹

Ndërkohë që informacioni mbi menaxhimin nga klienti të rreziqeve dhe ndikimeve M&S të HEC Lengarica u publikua në ESRS dhe PVMMS, IFC nuk publikoi VNMS e 2011, mbi të cilën kishte bazuar shqyrtimin e saj M&S. VNMS nuk u publikua as nga klienti, dhe as nuk u përkthye në shqip. Kështu, CAO gjen që IFC: (1) nuk u siguroi që klienti “të publikojë dokumentin e Vlerësimit për komunitetet e prekura” (SP1 paragrafi 20), dhe (2) nuk “bëri të disponueshme kopje elektronike dhe, aty ku është e mundur lidhje interneti, të çdo dokumenti përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis të përgatitur nga apo në emër të klientit” (Politika e Publikimit, paragrafi 13). Duke vënë në dukje mungesën e përkthimit të dokumentacionit të vlerësimit M&S në shqip, CAO gjen më tej që IFC nuk siguroi përputhshmërinë e klientit me kërkesat e SP1, për ta përshtatur informacionin e tij dhe proceset e konsultimit me preferencat gjuhësore të komuniteteve të prekura, në një mënyrë që është e përshtatshme nga ana kulturore (paragrafi 21).

Angazhimi para-investimor me palët e interesuara të prekura përbëhej nga një pyetësor të shpërndarë tek banorët e komunës Petran. Kjo u krye në fillim të vitit 2011 si pjesë e VNMS së përditësuar.⁶² Siç u raportua tek CAO nga klienti, kjo u bë në kontekstin e negociimit të marrëveshjeve të servitudit ndërmjet kompanisë dhe anëtarëve të komunitetit për përdorimin e tokave, dhe për të lehtësuar aksesin në ujtitje për qëllime bujqësore. Gjatë vizitës së CAO në HEC Lengarica, zyrtarët vendorë dhe kompania raportuan që diskutime të shumëfishta kanë ndodhur ndërmjet kompanisë dhe komuniteteve që u prekën nga marrja e tokës. Megjithatë, duket që klienti nuk ka kryer ndonjë konsultim me grupe të tjera të mundshme të prekura, siç janë operatorët turistikë vendorë apo përdoruesit e banjave termale të Benjës gjatë fazës së projektimit të HEC Lengarica.

⁵⁶ Standardi i Performancës 1 i IFC, Prill 2006, para. 26

⁵⁷ Standardi i Performancës 1 i IFC, Prill 2006, para. 19

⁵⁸ Standardi i Performancës 1 i IFC, Prill 2006, para. 21

⁵⁹ Standardi i Performancës 1 i IFC, Prill 2006, para. 21

⁶⁰ Standardi i Performancës 6 i IFC, Prill 2006, para. 11

⁶¹ Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social e IFC, enso Shqipëri, 29 Gusht 2011 - <https://goo.gl/8V1RRR>

⁶² *Ibid.*

Prandaj, CAO gjen qw IFC nuk siguroi që klienti ndërmori një proces konsultimi që tu ofronte “komuniteteve të prekura mundësi për të shprehur mendimin e tyre mbi rreziqet, ndikimet dhe masat zbutëse të projektit”, sipas kërkesave të SP1, para. 21.

Mbikëqyrja e IFC

Duke përjashtuar VMMS e vitit 2013, i cili është publikuar në anglisht në faqen e internetit të klientit, vlerësimet e ndikimit social dhe mjedisor apo raportet e monitorimit nuk ishin publikuar nga IFC apo klienti.⁶³ Klienti raportoi që këto dokumente jepeshin sipas kërkesave në zyrën qendrore dhe në nivel projekti. Dokumentacioni M&S pas aprovimit i prodhuar nga klienti renditet në faqen e internetit të klientit, por nuk bëhet publik. Në Prill 2016 kompania publikoi një raport të monitorimit të rrjedhës ekologjike në anglisht, pas nxitjes nga IFC. Vlerësimet M&S dhe raportet e monitorimit të klientit nuk u përkthyen në shqip as të plota dhe as si përmbledhje.

Nga viti 2014 dhe më vonë, dokumentacioni i mbikëqyrjes nga IFC tregon përpjekje për të inkurajuar klientin të forcojë aktivitetet e tij të angazhimit të palëve të interesuara. Nevoja për angazhim më të mirë të komunitetit u identifikua dhe nga konsulenti i pavarur i monitorimit në Nëntor 2013, duke vënë në dukje që një regjistër i përgjithshëm i angazhimit dhe komunikimit me palët e interesuara nuk ishte i disponueshëm.

Klienti përfundoi një Plan i Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI) për Lengaricën në vitin 2016. Angazhimi me grupe të ndryshme të palëve të interesuara është dokumentuar në PAPI. PAPI, sipas shqyrtimit nga IFC, konfirmon që HEC Lengarica kishte angazhim të kufizuar me grupet më të gjera të palëve të interesuara përpara fillimit të ndërtimit. Ai tregon që takime të mëtejshme me palët e interesuara të projektit u organizuan nga 2013 në 2015 në nivele kombëtare dhe lokale, përfshirë një tryezë të rumbullakët me organizata të shoqërisë civile në Tiranë në Tetor 2014, por jep informacion të kufizuar rreth aktiviteteve në vazhdim për angazhimin e palëve të interesuara.

CAO vë në dukje që klienti ngriti një zyrë lokale informacioni në Përmet dhe caktoi një nëpunës të lidhjes me komunitetin (CLO) në 2012, dhe që klienti ka vendosur një kuti ankesash në 2013. PAPI përshkruan rolin e CLO dhe procesin për trajtimin e ankesave. Kompania informoi CAO që deri në atë kohë, as shoqëria civile dhe as anëtarët e komunitetit nuk kanë kërkuar informacion të mëtejshëm në lidhje me HEC Lengarica.

Për ta përmbledhur, CAO njeh përpjekjet e mbikëqyrjes së IFC për të siguruar që klienti kishte rritur angazhimin e tij me grupet më të gjera të palëve të interesuara dhe përgatitur një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara. Megjithatë, mbikëqyrja e IFC për publikimet e informacionit M&S nga klienti ka mangësi për sa i përket Standardit të Performancës 1. Në veçanti, CAO gjen që IFC nuk ka siguruar që klienti ka plotësuar kërkesat për të publikuar informacion të monitorimit M&S në një format të aksesueshëm nga komunitetet e prekura (SP1, paragrafi 26).

⁶³ Siç është Raporti i Biodiversitetit 2012, Raporti i Hidrogeologjisë, Raporti mbi mishngrënësit e mëdhenj, lakuriqët e natës dhe zogjtë, Vlerësimi i llojeve të peshqve, dhe Vlerësimi i Ndikimit mbi Turizmin dhe Vlerësimi i Ndikimit mbi Peizazhin.

3. Përfundime dhe Vërejtje

Ky raport i përputhshmërisë i përgjigjet një ankese në lidhje me ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit të hidrocentralit të Lengaricës në Shqipëri, të ndërtuar nga klienti i IFC, enso Shqipëri. Ai merr në konsideratë shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e projektit nga IFC përkundrejt kërkesave të Standardeve të Performancës (SP) dhe kërkesave të tjera të politikës së IFC që lidhen me çështjen.

Ankesa e vitit 2015 nga banorët e zonës dhe ambientalistët ngre çështjen që HEC Lengarica ka pasur ndikime mbi llojet e rrezikuara dhe habitatet natyrore/kritike. Ajo supozon që ka ndikime mbi shërbimet e ekosistemit, në veçanti mbi vlerën ekoturistike e lumit të Lengaricës dhe të zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës afër tij. Ajo gjithashtu supozon që HEC Lengarica nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e IFC për publikimi i informacionit, konsultimin dhe angazhimin e palëve të interesuara.

Ky raport ka gjetur që ka pasur mangësi materiale në shqyrtimin para-investimor nga IFC të projektit, por këto janë përgjithësisht korrigjuar gjatë mbikëqyrjes. Çështjet e mbetura lidhen me; (a) publikimin e informacionit të vlerësimit dhe monitorimit M&S për HEC Lengarica; (b) vlerësimin dhe zbutjen e ndikimeve të projektit mbi turizmin; dhe (c) përputhjen e HEC Lengarica me planin e menaxhimit për Parkun Kombëtar *Bredhi i Hotovës-Dangëlli*, brenda të cilit ai është vendosur.

Duke filluar me ndikimet e supozuara mbi biodiversitetin, CAO gjen që shqyrtimi M&S nga IFC ka anashkaluar një numër mangësish në vlerësimin nga klienti të rreziqeve dhe ndikimeve të HEC Lengarica. Këto përfshijnë gabime dhe mangësi në VNMS e klientit që lidhen me: (a) identifikimin e llojeve të rrezikuara dhe endemike; (b) një mungesë vlerësimi të ndikimeve të grumbulluara (kumulative) që rrjedhin nga ndërtimi i hidrocentraleve të shumëfishtë mbi sistemin lumor të Lengaricës; dhe (c) mungesën e vlerësimit të mjaftueshmërisë së rrjedhës ekologjike. Megjithatë, këto mangësi në shqyrtimin e IFC u trajtuan gjatë zbatimit të projektit meqenëse u porositën studime shtesë të biodiversitetit dhe u ngrit një program i monitorimit të biodiversitetit. Rezultatet e monitorimit deri më sot nuk sugjerojnë që HEC Lengarica të ketë sjellë ndikime negative të matshme mbi biodiversitetin. Në këto rrethana, CAO gjen që mbikëqyrja nga IFC ka qenë e përshtatshme.

Çështja e vendndodhjes së HEC Lengarica brenda Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, gjithashtu nuk është shikuar në kohën kur IFC miratoi investimin në vitin 2011. Megjithatë, pasi çështja u ngrit nga palët e interesuara në vitin 2014, IFC ndërmori hapa për tu siguruar që klienti ka marrë lejet e nevojshme për ndërtimin dhe shfrytëzimin e HEC Lengarica. Ndërkohë që ankuesit kundërshtojnë ligjshmërinë e procesit të dhënies së lejeve, këto çështje janë jashtë fushëveprimit të një shqyrtimi të përputhshmërisë nga CAO. Megjithatë, vendndodhja e HEC Lengarica brenda një Parku Kombëtar vë në lëvizje dispozitën e zonës së mbrojtur sipas SP 6, dhe CAO gjen që kërkohet mbikëqyrje shtesë për të siguruar që aktiviteti dhe programet e klientit janë në përputhje me planin e menaxhimit të Parkut.

Ndikimet e HEC Lengarica mbi turizmin u vunë në dukje në shqyrtimin para-investimor të IFC, por IFC nuk u sigurua që ato ishin vlerësuar dhe zbutur në përputhje me kërkesat e SP1 apo SP6 përpara ndërtimit të projektit. Mbikëqyrja pasuese nga IFC e HEC Lengarica konfirmon ndikimet e projektit mbi disa lloje të aktiviteteve të ekoturizmit, veçanërisht lundrimi me kajak në Kanionin e Lengaricës. Megjithatë, në lidhje me këto ndikim, IFC nuk ka siguruar konsultim të mjaftueshëm me palët e interesuara apo që masat e përshtatshme për të minimizuar, zbutur dhe/ose mënjeluar ndikimet të përfshiheshin në PVMS siç kërkohet nga SP1.

Zbatimi i kërkesave të IFC për publikimin e informacionit, konsultimin dhe angazhimin e palëve të interesuara për HEC Lengarica është i paplotë. Konsultimi i palëve të interesuara gjatë fazës së

projektimit të HEC Lengarica ishte i kufizuar. Si pasojë, IFC punoi me klientin për të përgatitur një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara që dokumentoi angazhimet e klientit me grupe më të gjera të palëve të Interesuara gjatë periudhës 2013 – 2015. Në kundërshtim me kërkesat e SP1 dhe politikën e IFC për publikimin e informacionit, IFC nuk siguroi publikimin e VNMS të klientit të muajit Qershor 2011 mbi të cilin IFC bazoi shqyrtimin e saj M&S. Publikimi i dokumentacionit të mëtejshëm të vlerësimit dhe monitorimit M&S ka mangësi, si dhe informacioni në gjuhën vendase rreth rreziqeve dhe ndikimeve M&S të projektit.

Në dritën e gjetjeve që përmbahen në këtë raport, CAO do ta mbajë këtë hetim të hapur për monitorim, dhe do të nxjerrë një raport monitorimi jo më vonë se një vit pas publikimit të këtij hetimi. CAO do të monitorojë situatën deri sa veprimet e ndërmarra nga IFC të sigurojnë CAO-n që gjetjet e mos-përputhshmërisë janë adresuar.

Shtojca 1: Përmbledhje e Gjetjeve të Hetimit të CAO

Llojet e rrezikuara dhe habitatet natyrore/kritike;	
Shqyrtimi M&S Para-Investimor	<p>Mangësitë në VNMS e klientit për HEC Lengarica u anashkaluan në shqyrtimin M&S para-investimor të IFC. Këto përfshinin: (a) mungesa e informacionit të përshtatshëm mbi llojet e rrezikuara dhe endemike në zonën e ndikimit; (b) mungesa e vlerësimit të ndikimeve kumulative duke marrë në konsideratë projekte të tjera hidrocentralesh që po zhvilloheshin në sistemin lumor të Lengaricës, veçanërisht HEC Pulita menjëherë mbi rrjedhë nga HEC Lengarica; dhe (c) mungesën e vlerësimit të mjaftueshmërisë së rrjedhës së propozuar ekologjike. Shqyrtimi i IFC nuk kërkoi vlerësime shtesë për të mbyllur këto mangësi, sic kërkohet nga Politika e Qëndrueshmërisë.</p> <p>Prandaj, gjetja e CAO është që IFC nuk siguroi që klienti plotësonte kërkesën që “procesi i Vlerësimit do të bazohet në informacionin aktual, përfshirë një përshkrim të saktë të projektit dhe të dhëna të përshtatshme të gjendjes fillestare sociale dhe mjedisore” (SP1, paragrafi 4).</p> <p>Megjithatë, IFC i kërkoi klientit të kontraktonte një ekspert të biodiversitetit për të hartuar dhe menaxhuar zbatimin e një programi të monitorimit të biodiversitetit. Megjithëse nuk ishte kërkuar nga IFC, klienti i dha për detyrë konsulentit të biodiversitetit kryerjen e një analize të hendekut mes VNMS dhe kërkesave të SP6. Si rezultat, u rekomanduan vlerësime shtesë të ndikimeve të HEC Lengarica mbi biodiversitetin.</p>
Mbikëqyrja	<p>Gjatë mbikëqyrjes, klienti kreu vlerësime shtesë, të cilat adresuan mangësitë e identifikuar në VNMS 2011 në lidhje me ndikimet e mundshme mbi llojet e rrezikuara. Mbi bazën e informacionit të disponueshëm, përfundimi i IFC që HEC Lengarica nuk ka ndikim mbi habitatet kritike është në linjë me kërkesat e SP6.</p> <p>Ndërkohë që IFC kërkoi që rrjedha ekologjike të monitorohet pasi HEC të vihet në punë, IFC nuk i kërkoi klientit të ndërmerre një vlerësim për të konfirmuar përshtatshmërinë e rrjedhës ekologjike të përlllogaritur, duke mos zbatuar në këtë mënyrë kërkesat e Politikës së Qëndrueshmërisë, paragrafi 15.</p> <p>Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe vështirësitë e përcaktimit të vlefshmërisë së rrjedhës ekologjike, IFC inkurajoi klientin të përdorte një kuadër menaxhimi adaptiv. Rezultatet e monitorimit deri më sot nuk sugjerojnë që HEC Lengarica të ketë sjellë ndikime negative të matshme mbi biodiversitetin. Në këto rrethana, CAO gjen që mbikëqyrja nga IFC e çështjes së rrjedhës ekologjike ka qenë e përshtatshme.</p>
Ndikimi mbi jetesën e bazuar në turizëm	
Shqyrtimi M&S Para-Investimor	IFC nuk u siguroi që vlerësimi M&S i klientit për HEC Lengarica mori në konsideratë “vlerat e ndryshme që jepen ... nga palët të interesuara specifike, si dhe identifikimi i ndikimeve mbi shërbimet e ekosistemit” (SP6, paragrafi 4), veçanërisht ndikimet mbi ekoturizëm. Masat për të minimizuar, zbutur dhe/ose balancuar ndikimet e projektit mbi vlerën turistike të zonës nuk ishin përfshirë në PVMMS.
Mbikëqyrja	Ndërkohë që mbikëqyrja e IFC për projektin ka kapur çështjen e ndikimeve të HEC Lengarica mbi ekoturizmin, CAO gjen që IFC nuk u siguroi që palët e interesuara të konsultoheshin, vlerësimet të publikoheshin dhe masat për minimizimin, zbutjen dhe/ose balancimin e ndikimeve të shtoheshin në PVMMS.
Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës	
Shqyrtimi M&S Para-Investimor	Shqyrtimi i IFC nuk e identifikoi që HEC Lengarica të ishte i vendosur brenda Parkut Kombëtar <i>Bredhi i Hotovës-Dangëlli</i> . Si rezultat, IFC nuk vuri në veprim SP6, paragrafi 11, i cili përcakton kërkesat ndaj klientit kur ai planifikon një projekt në një zonë të

	mbrojtur ligjërisht. Po ashtu, IFC nuk mori në konsideratë çështjet e lidhura me zbatimin e ligjit shqiptar mbi zonat e mbrojtura.
Mbikëqyrja	Në vitin 2014, pasi u ngritën shqetësime publike në lidhje me vendndodhjen e HEC Lengarica në një park kombëtar, IFC shqyrtoi një mendim ligjor të porositur nga klienti. Kjo ofroi sigurinë që klienti kishte marrë lejet e nevojshme për ndërtimin e HEC Lengarica. Megjithatë, CAO gjen që kërkohet mbikëqyrje e vazhdueshme për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e SP 6 në lidhje me: (a) përputhjen e HEC Lengarica me planet e menaxhimit të Parkut Kombëtar; dhe (b) konsultimin me palët e interesuara të zonës së mbrojtur.
Publikimi i informacionit, konsultimi dhe angazhimi i palëve të interesuara.	
Shqyrtimi M&S Para-Investimor	Në fazën para-investimore, CAO gjen që IFC nuk zbatoi kërkesat përkatëse të publikimit të informacionit. Në veçanti, (1) IFC nuk u siguroi që klienti “të publikojë dokumentin e Vlerësimit [dhe] Planin e Veprimit për komunitetet e prekura” (SP1 paragrafi 20), përfshirë VNMS e vitit 2011 mbi të cilin ka bazuar shqyrtimin e saj M&S; dhe (2) IFC nuk “ka vënë në dispozicion kopje elektronike, dhe aty ku është e disponueshme, lidhjet e internetit për ... dokumentet përkatëse të vlerësimit të ndikimeve sociale dhe mjedisore” (Politika e Publikimit, paragrafi 13). Konsultimi para ndërtimit ishte kufizuar tek palët e interesit të ndikuara drejtpërdrejt nga blerja e tokës dhe aksesit në ujë, duke përjashtuar grupe më të gjera të palëve të interesuara siç janë ata që punojnë në sektorin e turizmit në zonë. IFC nuk siguroi që klienti ndërmori një proces konsultimi që tu ofronte këtyre grupeve “mundësi për të shprehur mendimin e tyre mbi rreziqet, ndikimet dhe masat zbutëse të projektit” (SP1, para. 21).
Mbikëqyrja	IFC nuk u siguroi që klienti plotësoi kërkesat e saj për publikim në lidhje me monitorimin M&S (PS1, paragrafi 26). Megjithatë, gjatë mbikëqyrjes së projektit, CAO pranon që IFC ka bërë përpjekje për të siguruar që klienti ka përgatitur një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara dhe ka shtuar angazhimin e saj me grupe më të gjera të palëve të Interesuara, siç janë operatorët turistikë.

Shtojca 2: Kronologjia e Momenteve Kryesore

Data	Momentet Kryesore, Ngjarjet dhe Dokumentet
2006	
	Kontrata e Koncesionit Ndërtim Operim Transferim ("BOT") nënshkruhet nga Hasi Energji sh.p.k.
	Të drejtat dhe detyrat e koncesionit transferohen tek Lengarica SPV.
2008	
	Parku Kombëtar Bredhi Hotovës-Dangëlli zgjerohet në 34.000 hektarët e tanishëm (më përpara ishte rreth 2.000 hektarë)
Prill	Koncesioni i jepet HASI Energji sh.p.k.
2009	
	Enso negocion me HASI, mbajtësit e koncesionit të Lengaricës
Prill	Ministri i Ekonomisë e ndryshon marrëveshjen e koncesionit nga dy faza në një.
2010	
	Enso merr shumicën e aksioneve të HEC Lengarica përmes HASI Energy sh.p.k.
	Aktiviteti i ndërtimit fillon në HEC Pulita.
2011	
	Dokumentet e tenderit i dorëzohen Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Mjedisit.
Mars	Kërkesa e parë e klientit për IFC
Prill	Takimi i shqyrtimit të konceptit nga IFC
Qershor	Vizita e vlerësimit nga IFC
Qershor	VNMS e përditësuar e porositur nga Asistenca Teknike e Green for Growth Fund
Gusht	Takimi i shqyrtimit të investimit nga IFC
Gusht	Përmbledhje e Investimit të Propozuar (PIP), Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social (PSMS) dhe Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS) të publikuar në faqen e internetit të IFC.
Shtator	Dorëzimi i kërkesës për leje mjedisore
Shtator	Miratimi nga Bordi i IFC
Tetor	Leja mjedisore e kërkuar nga Lengarica & Energji refuzohet me kërkesë për informacion shtesë, duke përfshirë koordinatat, përbërësit e projektit, masat rehabilituese dhe zbutja e ndikimeve.
Nëntor	Dokumentet e kërkuar dorëzohen në Ministri.

Data	Momentet Kryesore, Ngjarjet dhe Dokumentet
Dhjetor	Dorëzohet konsultimi publik/pyetësori i perceptimeve të komunitetit (100 pjesëmarrës)
2012	
Janar	Projekti i Lengaricës merr lejen mjedisore.
Shkurt	Angazhimi i IFC (nënshkrimi i dokumentacionit ligjor që lidhet me investimin)
Prill	Hartimi i Manualit të Procesit Mjedisor
Maj	Plani i Veprimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social (VMMS) Veprimi dhe Monitorimi Mjedisor dhe Social: Raporti i Biodiversitetit Veprimi dhe Monitorimi Mjedisor dhe Social: Raporti Hidrologjik
Qershor	Raporti mbi Mishngrënësit e Mëdhenj, Lakuriqët e Natës dhe Shpendët Grabitqarë në zonën e HEC Lengarica
Gusht	Studimi i Peshqve të Lumit (Lengarica) të Zonës Qendrore të Lumit të Vjosës, Spase Shumka dhe Pellumb Aleksii
Shtator	Projekti i Lengaricës merr miratimin nga Këshilli dhe Shoqata Bujqësore e Komunës Petran.
2013	
Mars	Vlerësimi i Ndikimit të Hydrocentralit mbi Zhvillimin e Turizmit në Komunën Petran
Mars	Disbursimi i parë i IFC
Qershor	Veprimi dhe Monitorimi Mjedisor dhe Social i ERM: Raporti Final i Ekzaminimit të Vlerësimit të Përshtatshëm
Korrik	Lengarica fillon ndërtimin
Nëntor	Shqetësimet e ngritura nga përfaqësuesi i autoritetit vendor në lidhje me ndikimet e HEC Lengarica mbi ujërat termale
2014	
Janar	HEC Pulita (menjëherë mbi HEC e Lengaricës) kalon në fazën e shfrytëzimit.
Shkurt	Vizitë Mbikëqyrëse në Terren e IFC
Tetor	Letër peticioni dërguar tek Drejtori i Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri, Drejtori i Zyrës së IFC në Shqipëri, Ministri i Energjisë dhe Industrisë, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Kulturës (<i>letra e peticionit Nr. 298/4 Prot.</i>)
Tetor	Enso Hydro organizon takim me OJQ/aktivitet informimi publik në Tiranë
Tetor	IFC i përgjigjet letrës së peticionit
Nëntor	Opinion ligjor i porositur nga klienti në lidhje me <i>letrën e peticionit Nr. 298/4 Prot.</i>
Nëntor	Takim me palët e interesuara në Tiranë
2015	
Mars	Monitorimi i pranisë së peshqve në lumin e Lengaricës

Data	Momentet Kryesore, Ngjarjet dhe Dokumentet
Mars	Vizitë Mbikëqyrëse në Terren e IFC
Qershor	Dorëzohet ankesa për CAO nga Shoqata e Bujqësisë Organike
Korrik	Ankesa për CAO konsiderohet e pranueshme
Shtator	IFC merr një letër të re peticioni Nuk jepet përgjigje.
Nëntor	Lengarica kalon në fazën e shfrytëzimit
Dhjetor	Del raporti i vlerësimit i CAO
2016	
Shkurt	Raporti mbi Rrjedhën e Mbetur dhe Pasojat Mjedisore
Shkurt	Del Raporti i CAO rreth Përfundimit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve
Maj	Vizitë Mbikëqyrëse në Terren e IFC
Maj	Del raporti i vlerësimit të përputhshmërisë i CAO
Qershor	Dalin termat e referencës për hetimin e përputhshmërisë nga CAO
Gusht	Raporti i Parë i Monitorimit të Biodiversitetit
Shtator	Vizitë Mbikëqyrëse në Terren e IFC
Nën-Dhje	Ekipi i hetimit të përputhshmërisë i CAO viziton Shqipërinë
Dhjetor	Raporti i Dytë i Monitorimit të Biodiversitetit
Dhjetor	Vizitë Mbikëqyrëse në Terren e IFC
2017	
Prill	Vizitë Mbikëqyrëse në Terren e IFC
Gusht	Raporti i Tretë i Monitorimit të Biodiversitetit
Tetor	Klienti rifinancon projektin e Lengaricës Pjesëmarrja e GGF and OeEB parapaguhet, dhe borxhi merret përsipër nga dega lokale e Intesa Sanpaolo Bank.
2018	
Prill	Raporti i Katërt i Monitorimit të Biodiversitetit